



RAPORTI DHE ANALIZA E INSPEKTIMIT

Viti 2023

**Inspektorati Shtetëror i Punës
Dhe Shërbimeve Shoqërore**

1. PËRMBAJTJA

2. PËRMBLEDHJE

- Historiku i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve

Shoqërore

- Misioni

- Deklarata e misionit

- Detyrat e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve

Shoqërore

5. ARRITJET

- Përgjegjësi specifike

6. RAPORTIME SIPAS DEPARTAMENTEVE

Drejtoria e Inspektimit të Punës

- Sektori i Analizës së Riskut

- Sektori i Mbyqyrjes për Marrëdhëniet e Punës

- Sektori i Mbyqyrjes për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

- Sektori i Statistikës

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

- Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme

- Sektori i Çështjeve Ligjore

- Sektori i Financës

Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore

7. PUBLIKIME DHE AKTIVITETE

- Nënshkrime/Marrëveshje/Takime

8. PROBLEMATIKA TË HASURA

9. OBJEKTIVAT PËR VITIN PASARDHËS

2. PËRMBLEDHJE

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) është autoriteti shtetëror i ngarkuar me funksionet e inspektimit në fushën e marrëdhënieve të punës dhe shërbimeve shoqërore. Raporti vjetor i ISHPSHSH-së për vitin 2023 paraqet në mënyrë të përmbledhur treguesit e inspektimit, arritjet, dhe problematikat që kanë ndodhur gjatë punës së trupës inspektuese gjatë këtij viti. Metodologjia e përdorur në hartimin e këtij raporti bazohet në të dhënat statistikore të treguesve të inspektimit, identifikimin e problematikave përmes analizës së gjetjeve, konsultimin me legjislacionin në lidhje me zbatimin e tij në praktikë, si dhe zhvillimin e platformave inovative.

Misioni i ISHPSHSH është të garantojë vende pune të denja, të sigurta dhe të shëndetshme nëpërmjet një sistemi inspektimi profesional dhe të përgjegjshëm, si dhe të promovojë një kulturë në zbatim të legjislacionit të punës. Sistemi i inspektimit në punë ka patur një progres të qëndrueshëm në vitet e fundit, në saj të rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe ato institucionale, rritjes së cilesisë së inspektimit nëpërmjet zhvillimit të sistemeve digjitale për menaxhimin e inspektimeve mbështetur në metodologji, procedura dhe funksione të qarta. Gjatë vitit 2023, janë inspektuar **216,594 vende pune**, ose marrëdhënie punësimi të verifikuara në **9,938 subjekte** të inspektuara.

Automatizimi i procesit të planifikimit në bazë të rrezikut është një arritje e rëndësishme gjatë vitit 2023, ku me mbështetjen e ILO-s në kuadër të projektit ESAP II, financuar nga EU është mundësuar zhvillimi i 2 sistemeve digjitale të inkuorpuara. Sistemi MPS “Matrica e dënimeve” shërben si bazë e të dhënave të inspektimeve që kryejnë inspektorët, dhe furnizon sistemin RAS “Sistemi i planifikimit mbi bazë Risku”, i cili mbështetur në teknologji të avancuar si “Data Mining” dhe “Machine Learning” realizon planifikimin e automatizuar. Automatizimi i procesit mundëson një bazë të përmirësuar të dhënash të cilat shërbejnë në identifikim të problematikave të zbatimit të dispozitave ligjore, apo në përcaktim të sektorëve/ çështjeve që kanë nevojë për ndërhyrje. Në mesataren vjetore, *83% e inspektimeve janë të planifikuara mbi bazë risku* dhe dispozitat ligjore të evidentuara në shkelje gjatë vitit 2023 rezultojnë: 1) Informaliteti (përfshirë edhe atë gri) përbën 32.4% të shkeljeve totale të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës, 2) Siguria dhe Shëndeti në punë përbën 30.8%, 3) Kushtet e Punës përbëjnë 24%, 4) Rregullimi i marrëdhënieve të punës përbën 9.3% dhe 5) dispozitat ligjore të tjera të shkelura përbëjnë 3.5%. Bashkëpunimi i përmirësuar me institucionet dhe partnerët si DPT dhe QKB ka ndihmuar në zgjerimin e hartës së subjekteve që marrin shërbimin e inspektimit për herë të parë, duke arritur në masën 22.3% të subjekteve të planifikuara.

Gjatë vitit 2023, janë depozituar në total **800 ankesa/kërkesa**, të cilat janë trajtuar kryesisht përmes proceseve të mirëfillta të inspektimit. 100% e kërkesave për sqarime ligjore kanë marrë përgjigje, duke ndikuar në qartësimin e situatave dhe indirekt në zbutjen e konflikteve potenciale. Numri më i madh i denoncimeve të adresuara dhe të trajtuara nga ISHPSHSH janë për shkelje të të drejtave dhe mospërbushje të detyrimeve të punëdhënësve kundrejt punëmarrësve të cilat përfshijnë mospagesën për punë të kryer në ditët e festave zyrtare, ditë të pushimit javor, punë të kryer në orë shtesë, moslidhje kontrate pune, dhe çështje të ngjashme.

Një fokus dhe vëmendje e veçantë në praktikën inspektuese mbetet edhe kontrolli i zbatimit nga ana e subjekteve të dispozitave ligjore të punës për kategoritë e veçanta të punëmarrësve, kryesisht “Punëmarrës nën 18 vjeç”, “Personat me aftësi ndryshe”, “Gratë shtatëzëna” etj. Rritja e punëmarrësve të huaj në Shqipëri është një trend i vërejtur në vitet e fundit, dhe është e rëndësishme që të respektohen dhe të mbrohen të drejtat e tyre në punë për një trajtim të barabartë dhe larg çdo diskriminimi.

Në lidhje me aksidentet në punë, të dhënat statistikore në vitet e fundit kanë paraqitur nivele të ngjashme për numrin e aksidenteve të regjistruara dhe hetuar nga institucioni, ndërkohë që viti 2023 ka shënuar një ulje të lehtë në numrin e punëmarrësve të aksidentuar në total dhe atyre me pasoja fatale. Janë klasifikuar dhe vërtetuar si aksident në punë për *168 punëmarrës*, nga të cilët *30 me pasojë humbjen e jetës*. Vlen të cilësohet që 40 punëmarrës të aksidentuar apo 23.8% janë aksidente rrugore që klasifikohen si aksident në punë për shkak të ligjit. Kjo ulje në numrat e aksidenteve është një tregues pozitiv për përmirësimin e kushteve të sigurisë në punë dhe për efektivitetin e masave të ndërmarrë për të parandaluar aksidentet në ambientet e punës. Gjithashtu, automatizimi i procesit të planifikimit mbi bazë risku dhe një bazë e përmirësuar të dhënash kanë ndihmuar në identifikimin e problematikave të shkeljeve të subjekteve, vlerësimin më të mirë të shkaqeve të aksidenteve të hetuara dhe identifikimin e sektorëve më problematikë në lidhje me këtë çështje. Kjo ka lejuar institucionin të ndërhyjë me masa konkrete për të parandaluar aksidentet në punë. Klasifikimi i sektorit të ndërtimit si një sektor me rrezik të lartë për aksidente në punë është për shkak të zhvillimeve të mëdha në këtë sektor në Shqipëri, ka shtuar vëmendjen e institucionit për të përmirësuar qasjen e inspektimit dhe për të zgjeruar kontrollin në kantierët e ndërtimit. Rritja e përqindjes së subjekteve me "Dokument Vlerësim Risku", fuqizimi i rolit të Koordinatorit dhe Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, si dhe i Mjekut të ndërmarrjes, tregojnë një angazhim të rritur për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Pranueshmëria dhe dakortësia me vendimet e inspektimit tregojnë për një tendencë pozitive në zbatimin e tyre. Kurba në ulje për vitin 2023 të vendimeve përfundimtare të ankimuara administrativisht, si dhe ulja e ankimimeve ndaj vendimeve me gjobë, tregon për një rritje të besimit të subjekteve në procesin e vendimmarrjes dhe për një përmirësim të komunikimit dhe transparencës nga ana e institucionit. Ankimimi i 30% të vendimeve me gjobë në vitin 2023 është një shifër mjaft e ulët krahasuar me vitet e mëparshme. Vendimarrja e trupës kolegjiale për aktrimimet e ushtruara për vitin 2023 është kryer brenda afateve ligjore, ku është vendosur për **43** vendime inspektimi lënia në fuqi, **6** vendime inspektimi janë ndryshuar (në 5 vendimarrje është vendosur për ndryshim të masës nga gjobë në paralajmërim dhe në 1 rast për ulje të vlerës së gjobës) dhe shfuqizime kanë qënë **zero**. Vetëm 15 vendime të Komisionit të Ankimit, ose 30% e tyre, janë ankimuar në Gjykatë dhe në 100% të çështjeve për të cilat gjykata është shprehur me vendim, është mbajtur në fuqi Vendimi i Inspektimit dhe i Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së.

Gjatë vitit 2023 dhe në vazhdim, ISHPSHSH ka pasur një përfshirje dhe angazhim të rëndësishëm në hartimin e strategjive, plan veprimeve dhe raportimeve në Progres-Raport në kuadër të procesit të integritetit në BE sic janë Kapitulli 19 "Politikat Sociale dhe Punësimi", Kapitulli 20 "Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale", Kapitulli 2 "Lëvizja e Lirë e Punëtorëve", Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", Nënkomitetin Inovacioni dhe Shoqëria e Informacionit, etj. Gjithashtu, ISHPSHSH është pjesë e grupit të punës së ngritur me Urdhër të

Kryeministrit nr. 108, datë 08.09.2023, për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës, për Hartimin e Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2023-2030 dhe Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030.

Drejtorja e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore ka një rol kryesor në inspektimin e ofruesve të shërbimeve, vlerësimin e standardeve për subjektet që duhet të liçensohen, inspektimin e ankesave dhe kërkesave të përfituesve dhe strukturave që mbrojnë të drejtat e njeriut. Gjatë vitit 2023, kjo strukturë ka ushtruar kontrolle për të siguruar respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror duke realizuar 108 inspekte të qendrave të përkujdesit shoqëror. Propozimi për *revokim të licencës për 6 subjekte jopublike*, të licensuara për shërbime të kujdesit komunitar, është një masë administrative e rëndësishme që ka për qëllim të sigurojë respektimin e standardeve dhe ligjeve në këtë fushë.

Komunikimi dhe informimi publik janë thelbësore për të siguruar transparencën dhe për të ndërtuar marrëdhënie të drejtpërdrejta me publikun në lidhje me aktivitetin e institucionit. Duke përdorur mjete, kanale dhe platforma të ndryshme komunikimi, ISHPSSHSH ka informuar dhe ndërgjegjësuar vazhdimisht publikun në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të garantuar një ambient të sigurtë dhe të denjë për të gjithë.

Në kontekstin, ku roli i organizatave sindikale është ende i pamjaftueshëm dhe mungojnë praktikatat, një drejtim i rëndësishëm i punës së ISHPSSHSH-së është konsolidimi i marrëdhënies me partnerët social për parandalimin, monitorimin e sinjalizimin të rasteve të mosrespektimit të të drejtave të punëmarrësve, në përmbushje të funksionit për zbutjen e konflikteve në vendin e punë.

Realizimi i buxhetit për vitin 2023 në drejtorinë qendrore është në masën **99%**, realizimi më i mirë i buxhetit ndër vite për ISHPSSHSH-në. Përvoja e suksesshme me realizimin e buxhetit për vitin 2023 është një tregues i rëndësishëm për një mirëmenaxhim të fondeve buxhetore në drejtorinë qendrore dhe për institucionin është shumë inkurajues dhe tregon që planifikimi vjetor dhe administrimi është bërë me kujdes

Inspektimet e zgjuara mbështetur në një planifikim me bazë risku, ndërgjegjësimi, rritja e bashkëpunimit, komunikimit dhe këshilimi punëdhënësve dhe punëmarrësve janë domosdoshmëri në kushtet kur burimet njerëzore dhe financiare për inspektimin janë të kufizuara për të përmbushur efektivisht objektivat e përcaktuara për vitin 2024. Fuqizimi i planifikimit me bazë risku ku nëpërmjet zhvillimit dhe përmirësimit të sistemeve digjitale, si Matrica e Dënimeve (MPS), Sistemi i Analizës së Riskut (RAS) dhe e-Inspektimi, do të sjellë një rritje të qartësisë dhe efikasitetit të inspektimit. Një fokus i veçantë është vendosur në promovimin e një kulture parandaluese për vende pune të sigurt, të shëndetshme dhe productive dhe në mbështetje të misionit të saj që ISHPSSHSH është e angazhuar ta përmbushë me dinjitetet, një rëndësi e veçantë i është kushtuar integritetit dhe etika institucionale për të ofruar një shërbim sa cilësor, të ndershëm, transparent por edhe të barabartë për të gjithë qytetarët shqiptarë.

Historiku i ISHPSHSH-së

Historiku i ISHPSHSH-së fillon me krijimin e saj në vitin 1994 si një institucion qendror dhe buxhetor. Përmes procesit të inspektimit dhe verifikimit të kërkesave ligjore për zbatimin e legjislacionit të punës dhe të shërbimeve shoqërore nga subjektet, ISHPSHSH-ja kryen veprimtarinë e saj në zbatim të ligjit nr. 9634 /2006 “Për inspektimin në punë” (i ndryshuar) si dhe Ligjit nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”. Institucioni aktualisht është në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe ka zhvilluar ndryshime të ndjeshme dhe zhvillime të vazhdueshme në fushën e inspektimit të punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

3.HYRJE

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) është autoriteti shtetëror i ngarkuar me funksionet e inspektimit në fushën e marrëdhënieve të punës dhe shërbimeve shoqërore. Raporti i analizës vjetore hartohet bazuar në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe përmbledh aktivitetet dhe arritjet e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të realizuara gjatë vitit 2023. Veprimtaria inspektuese shtrihet dhe organizohet në të gjithë territorin e vendit përmes gjashtë Drejtorive Rajonale që kanë në përbërje të tyre 13 sektorë. Procedurat inspektuese kryhen online nëpërmjet sistemit "e-inspektimi", në kohë reale dhe në prani të subjektit të inspektuar. Aktualisht, sipas INSTAT (publikuar më 01.06.2023), numri i subjekteve aktive në Shqipëri është rreth 209,590, ndër të cilat 84,369 janë fermerë të pajisur me numër identifikimi të Personit të Tatuësëm NIPT, të cilët nuk janë në fokusin kryesor të inspektimit të punës. ISHPSHSH luan një rol kyç në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve, në promovimin e ambienteve të punës të sigura dhe të shëndetshme, si dhe në sigurimin që ofruesit e shërbimeve shoqërore të përmbushin standardet e kërkuara.

Misioni

Misioni i Inspektoratit Shtetëror të Punës është të sigurojë respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të punës në vendin e punës. Inspektorati kryen inspekte dhe kontrole për të siguruar kushte të sigura dhe të shëndetshme të punës, pagesa të drejta dhe orar të rregullt të punës. Përmes masave administrative dhe këshillimit, Inspektorati promovon njohuritë dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të punonjësve dhe punëdhënësve sipas ligjeve të punës, duke synuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe sigurimin e mirëqenies së punëtorëve në të gjitha sektorët.

Deklarata e misionit

Të garantojë vende pune të denja, të sigura dhe të shëndetshme nëpërmjet një sistemi inspektimi profesional dhe të përgjegjshëm, si dhe të promovojë një kulturë në zbatim të legjislacionit të punës.

Detyrat e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

ISHPSHSH-ja në zbatim të ligjit nr 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punë” (i ndryshuar me ligjin nr. 57/2017) ka përgjegjësi të sigurojë:

- a) zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, përfshirë kohën e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë që inspektorët e punës janë ngarkuar të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave;
- b) ofrimin e informacionit teknik dhe këshillave për punëdhënësit dhe punëmarrësit në lidhje me mjetet më efektive të shqyrtimit të dispozitave ligjore që mbulojnë çështjet e punës;
- c) sjellje në dijeni të autoriteteve përgjegjëse për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen në mënyrë të specifikë nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të propozojë masat dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e situatës.

4. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

ISHPSHSH-ja si institucion ekzekutiv ka si qëllim garantimin e veprimtarisë inspektuese të inspektorëve të punës në frymën e ligjit dhe në koherencë të plotë me objektivat që ka institucioni. Për këtë vëmendje të posacme merr:

- Rritja e efektivitetit të procesit të inspektimit të punës, për të siguruar zbatimin e ligjit nga subjektet në të gjithë vendin
- Identifikimi i punësimit jo në përputhje me ligjin dhe adresim i tyre apo referimi pranë institucioneve përgjegjëse
- Monitorimi dhe raportimi i vazhdueshëm i cilësisë së procesit të inspektimit që kryhet nga trupa inspektuese.
- Zhvillimi sistemeve digjitale për të rritur profesionalizmin dhe për të mbështetur teknikisht inspektimin e punës
- Sigurimi i transparencës dhe integritetit gjatë procesit të inspektimit
- Promovimi i një kulture parandaluese për vende pune të sigurta, të shëndetshme dhe produktive përmes fushatave këshillimore dhe përdorimit efektiv të kanaleve digjitale

Raporti vjetor i ISHPSHSH-së për vitin 2023 paraqet në mënyrë të përmbledhur treguesit e inspektimit, arritjet, dhe problematikat që kanë ndodhur gjatë punës së trupës inspektuese gjatë këtij viti. Gjithashtu, raporti përmban konkluzione për përmirësimin e veprimtarisë së institucionit përmes hartimit të objektivave të qarta për vitin 2024. Metodologjia e përdorur në hartimin e këtij raporti bazohet në të dhënat statistikore të treguesve të inspektimit, identifikimin e problematikave përmes analizës së gjetjeve, konsultimin me legjislacionin në lidhje me zbatimin e tij në praktikë, si dhe zhvillimin e platformave innovative.

Të dhënat e inspektimit përfshijnë:

- Instrumentat e **fushës së punës** realizuar nga 6 Drejtoritë Rajonale, ku përfshihen;
 - numrin e inspektimeve të realizuar nga çdo inspektor pune,
 - llojit të inspektimit të kryer,
 - llojit të aktivitetit ekonomik,
 - numrit të aksidenteve në punë,
 - numri i ankesave,
 - informaliteti në të gjitha format e tij,
 - punësim kategorish të veçantë punëmarrësish (të mitur, të huaj)
 - shkeljeve të dispozitave ligjore,

- masave administrative
- Instrumentat e **fushës së shërbimeve shoqërore** ku përfshihen,
 - të dhëna për kapacitetet e qendrave të përkujdesit,
 - pyetësor për menaxherët dhe drejtues të qendrave,
 - pyetësor për punonjësit social,
 - intervistat me përfituesit,
- Identifikimi i problematikave nga analiza e gjetjeve duke parë krahasimisht trendin pozitiv dhe negativ të çështjeve specifike, që reflektojnë nga njëra anë nivelin e zbatimit të legjislacionit të punës nga punëdhënësit në aktivitetet ekonomike të tyre dhe nga ana tjetër ato të standarteve të shërbimeve shoqërore në qendrat e përkujdesjes sociale.
- Konsultimi me legjislacionin në raport me zbatimin në praktikë të tij, duke identifikuar çështjet apo situatë që nuk mbulohen shprehimisht nga ligji apo vetë situata dhe rrethanat e bëjnë të pa zbatueshme në praktikë një dispozitë ligjore. Për të dyja konstatimet, evidentim të adresimit të problematikës/ave në autoritetin përgjegjës.
- Zhvillimin e metodologjive, platformave inovative, duke evidentuar arsyet, qëllimin dhe çfarë synohet përmes zhvillimit të tyre.

5. ARRITJET

Gjatë vitit 2023, janë inspektuar **216,594 vende pune**, ose marrëdhënie punësimi të verifikuara në **9,938 subjekte** të inspektuara. Edhe pse rezultojnë 2.1% inspektime më pak se në vitin 2022 (kjo për shkak të një numri të rritur të pozicioneve vakante në trupën inspektuese), disa tregues inspektimi kanë rezultuar në rritje cilësore krahasuar me një vit më parë, ku më konkretisht:

- ✓ **22.3%** e inspektimeve janë kryer në subjekte të pa inspektuara më parë duke bërë zgjerimin e hartës së subjekteve që mbulohen nga inspektimi i punës.
- ✓ Janë konstatuar **1,965** punëmarrës informal ose **9.2%** më shumë se një vit më parë, nga të cilët për 1949 prej tyre është formalizuar marrëdhënia e punësimit brenda procesit inspektues, përmes masave ligjore të marra nga inspektorët.
- ✓ Në lidhje me kontrollin e kontratave individuale të punës na rezulton një përmirësim i lehtë i punonjësve të konstatuar të punojnë pa një dokument të tillë. Janë trajtuar për formalizim të plotë të marrëdhënies së punësimit, **2,502** punëmarrës pa kontrata individuale pune të konstatuar ose rreth 15% më pak se konstatimi i vitit 2022.
- ✓ Vëmendje e posaçme ka patur kontrolli i marrëdhënieve dhe kushteve të punës për katëgoritë e veçanta të punëmarrësve “Nën 18 vjeç” dhe “PAK”, e ku rezultojnë:
 - 215 punëmarrës nën 18 vjeç ose 25 % më shumë se një vit më parë të verifikuar
 - 1350 Punëmarrës të huaj ose 628 punëmarrës më shumë, krahasuar me vitin 2022
- ✓ **36%** e dënimeve me gjobë të 2023 janë ankimuar administrativisht pranë Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së, me një ulje të konsiderueshme të ankimit nga 64 % (viti 2020); 38% (viti 2021); 30% (viti 2022). Pas trajtimit 87% e ankimeve janë lënë në fuqi nga Komisioni i Ankimit, nga 76 % të vendimeve të lëna në fuqi në vitin 2022. (77% në 2021 dhe 60% në 2020)
- ✓ **75.2 %** të ankesave dhe/ose denoncimeve kanë marrë zgjidhje plotësisht ose pjesërisht pas trajtimit, e ku 20% e punëmarrësve kanë shprehur falenderimet e tyre për zgjidhjen e pretendimeve që kishin.

- ✓ Rritja e ndërgjegjësimit të punëdhënësve kundrejt detyrimeve ligjore, ku tashmë pjesë e njoftimeve bëhen jo vetëm aksidentet, por dhe incidentet në punë (aksidente pa pasoja në njerëz). Për vitin 2023 rezultojnë 9 incidente në punë të deklaruar pranë ISHPSHSH-së.
- ✓ Pas marrëveshjes së arritur me QKB-në (Qëndrën Kombëtare të Biznesit) duke filluar nga muaji qershor 2023, janë informuar me informacion ligjor të hartuar nga ISHPSHSH-ja, gjithsej **9,333** subjekte ekonomike të reja të regjistruara, mbi të drejtat dhe detyrimet e Legjislacionit të Punës.
- ✓ Vizita inspektuese me bazë këshillimi në subjekte të ndryshme, duke shpërndarë fletë-palosjet informuese dhe këshilluese për krijimin e një ambienti pune të sigurt e të shëndetshëm nën sloganin “Siguria Mbron Njerëz”. Është kryer përgatitja dhe realizuar shpërndarja e 4,500 fletë-palosjeve me përmbajtje informuese në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- ✓ Në kuadrin e shpenzimeve buxhetore, viti 2023 është viti me realizimin më të lartë në historikun e institucionit duke realizuar buxhetin e akorduar në masën 99% dhe duke përfunduar cdo shpenzim apo investim sipas planit. Në zërin e investimeve një peshë të rëndësishme kanë zene investimet e realizuara me financime nga donatorë të huaj të cilët kanë munësuar financimin e plotë për zhvillimin e dy sistemeve teknologjike.

Automatizimi i procesit të planifikimit në bazë të rrezikut është një arritje e rëndësishme gjatë vitit 2023, ku me mbështetjen e ILO-s në kuadër të projektit ESAP II, financuar nga EU është mundësuar zhvillimi i 2 sistemeve digjitale të inkorporuara MPS dhe RAS. Sistemi MPS “Matrica e dënimeve” shërben si bazë e të dhënave të inspektimeve që kryejnë inspektorët, dhe furnizon sistemin RAS “Sistemi i planifikimit mbi bazë Risku”, i cili mbështetur në teknologji të avancuar si Data Mining dhe Machine Learning do mundësojë planifikimin e automatizuar. Automatizimi i procesit mundëson një bazë të përmirësuar të dhënash të cilat shërbejnë në identifikim të problematikave të zbatimit të dispozitave ligjore, apo në përcaktim të sektorëve/ çështjeve që kanë nevojë për ndërhyrje.

PËRGJEGJËSI SPECIFIKE

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore siguron një informacion të përditësuar për fushën e inspektimit në punë. Mbledh dhe përpunon të dhënat statistikore që dalin nga procesi i inspektimit në punë kryesisht për:

- kushte punë të denja,
- hetimin e aksidenteve në punë,
- mbrojtje e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre,
- ligjshmërinë në zbatimin e kohëzgjatjes së punës,
- pagesës për punë të kryer konform legjislacionit,
- sigurimit të çdo punëmarrësi,
- higjenës dhe mirëqenies në vendin e punës,
- punësimit të ligjshëm të fëmijëve,
- të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kontrata individuale e punës,
- zbatimin e marrëveshjeve kolektive të punës,
- çështje të tjera, që lidhen ngushtë me marrëdhëniet e punës si dhe sigurinë dhe shëndetin.

Bashkëpunon me Autoritetet e tjera ligjzbatuese dhe Organizata Kombëtare dhe Ndërkombëtare, për çështje që janë pjesë e fushës së kompetencës. Në këtë kuadër gjatë vitit 2023 mund të cilësojmë vijimin e punës me/përmës;

- Memorandum Bashkëpunimi me QKB - Informimi i subjekteve të reja në kohë reale nëpërmjet e-Albania mbi të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga Legjislacioni i Punës.
- DPT për shkëmbimin e informacionit të të punësuarve për çështje të kontrollit të informalitetit.
- AKPA për shkëmbimin e informacionit për çështje të përbashkëta kryesisht, punëmarrësit e huaj.
- Agjensinë e Prokurimit Publik për shkëmbimin e informacionit periodik në lidhje me subjektet që rezultojnë me gjobë, me qëllim përjashtim të tyre nga pjesëmarrja në tendera
- Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për ndërveprim me qëllim parandalimin, reduktimin dhe adresimin e mosbarazisë dhe diskriminimit.
- Draftimi i Marrëveshjes ndërmjet ISHPSHSH-së dhe Qendrës Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm (ASDO).
- Organizatave Kombëtare dhe Ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të punës.


Përfshirje dhe angazhim në hartimin e strategjive, plan veprimeve dhe raportimeve në Progres-Raport në kudër të procesit të integritetit në BE, etj. më konkretisht në;

- Kapitulli 19 "Politikat Sociale dhe Punësimi" Kapitulli
- Kapitulli 20 "Ndërrmarjet dhe Politikat Industriale",
- Kapitulli 2 "Lëvizja e Lirë e Punëtorëve"
- Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore"
- Nënkomitetin Inovacioni dhe Shoqëria e Informacionit
- Nënkomitetin Shqipëri-BE "Për çështjet ekonomike e financiare dhe statistikat" ECOFIN
- Raportim mbi format më të këqija të punës së fëmijëve pranë Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave
- Raportim për të drejtat e njeriut dhe punën e fëmijëve pranë Ambasadës Amerikane
- Pjesë e grupit të punës së ngritur me Urdhër të Kryeministrit nr.108, datë 08.09.2023 "Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës, për Hartimin e Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2023-2030 dhe Planit të Veprimit" në zbatim të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030
- Kontribut mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.162/2020, "Për prokurimin Publik"
- Pjesëmarrje në hartimin e një politike dhe studimi për pagën minimale të diferencuar sipas profesioneve.
- Kontribut në hartimin e Programin Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian PKABE/PKIE.
- Pjesëmarrje në themelimin e Tryezës së Diskutimit dhe Këshillimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian për kapitullin 2 "Liria e lëvizjes së punëtorëve".
- Kontribut lidhur me dokumentet e acquis që përfshijnë vepra penale për kap 2" Liria e lëvizjes së punëtorëve" për tu përfshirë në Kodin e Ri Penal.

6. RAPORTIMI SIPAS DEPARTAMENTEVE

Përbërja organizative dhe Organigrama

ISHPSHSH, si pjesë e administratës publike funksionon mbështetur në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Struktura e miratuar bazuar në Urdhrin nr. 156, datë 24.11.2020 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, është e organizuar në dy nivele: qendror dhe rajonal. Struktura ka në përbërje të saj 165 punonjës, në Drejtorinë e Përgjithshme dhe 6 Drejtori Rajonale.



DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PUNËS

Drejtoria e Inspektimit të Punës menaxhon dhe mbikqyr të gjithë procesin e inspektimit të punës, për të siguruar zbatimin e dispozitave ligjore që mbulojnë fushën e punës. Siguron dhe promovon një kulturë parandaluese në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë, për të pasur vende pune të sigurta, të shëndetshëm e produktive. Analizon të dhënat e inspektimit të punës sipas llojit të aktiviteteve ekonomike, duke orientuar planifikim të inspektimeve mbi bazë risku për drejtoritë rajonale, mban marrëdhënie me publikun, adreson problemet dhe ankesat, aksidentet në punë dhe çështjet e marrëdhënieve të punës dhe të sigurisë e shëndetit në punë duke u siguruar që çështjet të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Puna e kësaj drejtorie menaxhohet nga sektorët teknikë të cilët mbikqyrin, administrojnë dhe trajtojnë çështje specifike që lidhen me inspektimin e punës dhe ka në përbërje të saj 4 sektore: 1) Sektori i Analizës së Riskut; 2) Sektori i Mbikqyrjes së Marrëdhënieve të Punës; 3) Sektori i Mbikqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë; dhe 4) Sektori i Statistikës.

Sektor i Analizës Së Riskut (SAR)



Sektori i Analizës së Riskut (SAR) ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të inspektimit. Ky sektor asiston dhe mbikqyr procesin e programimit të inspektimit të punës në nivel rajonal, duke siguruar që programet e inspektimit të jenë efektive dhe të orientuara drejt sektoreve apo subjekteve me rrezik më të lartë. SAR si pjesë e Drejtorisë së Inspektimit të Punës ka ndikimin e vet në përmirësimin e cilësisë së procesit të inspektimit në tërësi për gjithë strukturën inspektuese, si dhe sigurohet për administrimin, funksionimin dhe përmirësimin në vazhdimësi të platformave digjitale që përdoren nga inspektorët e punës.

Planifikimi i Inspektimit

Procedura e inspektimit të punës kryhet sipas rregullave dhe standarteve të përcaktuara nga ligji i inspektimit, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ku një rol shumë të rëndësishëm zë procesi i planifikimit të inspektimeve. ISHPSHSH harton plan mujor inspektimi, bazuar në metodologjitë e vlerësimit të riskut, mbi bazë të prioriteteve dhe tematikave kryesore përkatëse të inspektimit. Mesatarisht 83% e inspektimeve që realizohen në bazë vjetore janë inspektime të planifikuara. Gjatë vitit 2023, përmes projektit ESAP II, dhe mbështetjes financiare të Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO), është punuar intensivisht në zhvillimin dhe përmirësimin e kriterëve dhe indikatorëve që përcaktojnë nivelin e riskut për një subjekt, të cilat më pas shërbyen si bazë për zhvillimin e një sistemi inteligjent për planifikim inspektimi të automatizuar mbi bazë risku. Këto përpjekje dhe zhvillime të rëndësishme përgjatë vitit 2023 kanë dhënë një ndikim të drejtpërdrejtë në një përmirësim të ndjeshëm të procesit të planifikimit. Mbi këtë bazë janë orientuar programimet mujore i subjekteve për inspektim, që eventualisht kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në rezultate inkurajuese të lidhura me zbatimin e legjislacionit dhe punës së denjë. Në këtë kuadër ka rezultuar se gjatë vitit 2023;


- Dispozitat e legjislacionit të punës, zbatohen në masën 18% të inspektimeve të kryera me një rritje rreth 3% krahasimisht me vitet më parë.
- 82% e inspektimeve të kryera, kanë shkelje të dispozitave ligjore, me një mesatare prej 2.5 shkeljesh për subjekt të inspektuar.

Në inspektimet që janë realizuar mbi bazë planifikimi risku, kemi këtë panoramë të dispozitave ligjore të evidentuara, si shkelje gjatë vitit 2023.

- **Informaliteti** (përfshirë edhe atë gri) përbën **32.4%** të shkeljeve totale të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës. Kjo shifër tregon vëmendje të shtuar në planifikim inspektimi të subjekteve që sipas indikatorëve të përdorur në përzgjedhjen në planifikim inspektimi kanë rezultuar më risk potencialisht të lartë për mbartjen e këtij fenomeni.
- **Siguria dhe shëndeti në punë** përbën **30.8%** të shkeljeve totale të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës. Zbatimi i dispozitave ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë, si fundament i “punës së denjë” kanë qënë në fokus të punës së ISHPSHSH duke vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme koeficientët e riskut për të gjithë elementet që ndikojnë tek siguria dhe shëndeti në punë.
- **Kushtet e Punës** përbëjnë **24%** të shkeljeve totale të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës.
- **Rregullimi i marrëdhënieve të punës** përbën **9.3%** të shkeljeve totale të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës.
- **Të tjera** dispozita ligjore të shkelura përbëjnë **3.5%** të shkeljeve totale të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës.

Falë përmirësimit të ndjeshëm bashkëpunimin me institucione dhe partnere si DPT dhe QKB është zgjeruar harta e subjekteve që marrin shërbimin e inspektimit për herë të parë deri në masën **22.3%** e inspektimeve të planifikuara për inspektim në vitin 2023, **ose 2.3%** më shumë se objektivi i parashikuar, për kategori subjektësh në planifikim. Gjatë vitit 2023, janë vlerësuar të jenë pjesë e planeve inspektuese edhe subjektet shtetërore, nisur nga historiku i ankesave që vijnë nga të punësuar në këtë sektor. Krahasimisht nga një vit më parë ku 27.4% e inspektimeve në subjektet shtetërore të inspektuara iniciuar si planifikim inspektimi, këtë vit janë 47.4% inspektimeve në subjektet shtetërore të planifikuara.

Në grafikun e mëposhtëm jepet një tablo e orientimit të planifikimit të inspektimit gjatë vitit 2023 në të cilën duket qartë prioriteti i planifikimit kanë qënë subjektet me risk potencial të mbartjes së informalitetit gri (një marrëdhënie punëdhënës-punëmarrës, duke përfshirë moszbatim të dispozitave ligjore në lidhje me kontratat e punës, pagesa për punë të kryer në ditët e festave zyrtare, orëve përtej kohëzgjatjes normale të punës etj). Risku potencial për informalitet gri është projektuar në 24.8% e subjekteve të planit vjetor të inspektimeve.



Administrimi dhe Zhvillim i Infrastrukturës Digjitale

Aktualisht inspektorët e punës kanë në përdorim 3 platforma digjitale, të cilat janë mjete mjaft të rëndësishme në mbështetje të cilësisë dhe efikasitetit të procesit të inspektimit të punës.

1- **Platforma “e-inspektimi”**, është një sistemi që përdoret për të lehtësuar dhe për të sistematizuar procesin e inspektimit. Kjo përfshin planifikimin e inspektimeve, regjistrimin e të dhënave gjatë inspektimit, dhe ndjekjen e progresit të ndërmarra për të adresuar gjetjet shkeljet e zbuluara gjatë inspektimit. Kjo platformë mundëson kryerjen e procesit inspektues në kohë reale dhe administrohet nga Inspektorati Qëndror.

2- **Matrica e Dënimeve (MPS)**, është një sistem i ngritur që shërben si ndihmë për inspektorët e punës për të siguruar një vendimarrje të unifikuar sipas parashikimit ligjor. Ky sistem mer në konsideratë dhe përpunon informacionin e 3200 dispozitave ligjore dhe mbi bazën e historikut të shkeljeve të subjektit, propozon masën e dënimit të parashikuar sipas ligjit me parim proporcionalitetin. Një sistem i përmirësuar MPS 2.0 është zhvilluar gjatë vitit 2023.

3- **Sistemi i Analizës së Riskut (RAS)** është i integruar në sistemin MPS dhe mundëson orientimin e planifikimit mujor të inspektimit mbi bazë risku tërësisht të automatizuar, duke u mbështetur në teknologjitë e avancuara si “Data minning” dhe “Machine Learning” të cilat vlerësojnë bazuar në historinë e inspektimeve, peshat specifike të rrezikut për secilin sektor apo indikator të tjerë. Ky sistem i avancuar përfundoi zhvillimin në Dhjetor 2023 me mbështetjen teknike dhe financiare të ILO dhe BE, dhe aktualisht është në fazë pilotimi.

Sektori i Mbikqyrjes Për Marrëdhëniet e Punës



Sektori i Mbikqyrjes së Marrëdhënieve të Punës ka si detyrë funksionale monitorimin, administrimin dhe mbikqyrjen e trajtimit të ankesave të depozituara pranë ISHPSHSH-së, si dhe çështjet që lidhet me marrëdhëniet e punësimit përfshirë edhe kategoritë e veçanta të punëmarrësve, sic janë të miturit, apo gratë shtatzana për të cilët ka parashikime ligjore të veçanta. Përmes punës së Sektorit të Mbikqyrjes së Marrëdhënieve të Punës, institucioni siguron që të gjitha ankesat dhe çështjet e punësimit trajtohen në përputhje me ligjin dhe në mënyrë të drejtë për të mbrojtur të drejtat e punonjësve dhe zbatuar ligjin në mënyrë efektive.

Administrimi i Ankesave

Sektori administron në formë elektronike “Rregjistrin e Ankesave”, në të cilin rregjistrohen të gjithë ankesat/denoncimet/kërkesat që depozitohen pranë institucionit në nivel qendror dhe rajonal. Gjatë vitin 2023 janë depozituar në total **800** ankesa/kërkesa prej të cilave:

- **90 %** janë depozituar drejtpërdrejtë pranë ISHPSH në kanalet e komunikimit të ndërtuara për këtë qëllim dhe **10 %** janë përcjellë nga Platforma e Bashkëqeverisjes
- **82.5 %** janë ankesa/denoncime nga punëmarrës dhe **17.5%** janë kërkesa për informim dhe sqarime ligjore, tregues i transparencës institucionle dhe besimit në informacion

Trajtimi i ankesave është kryer kryesisht përmes proceseve të mirëfillta të inspektimit, ndërkohë që pjesa tjetër është trajtuar me përgjigje bazuar në të dhëna të disponuara në institucion. 100% e kërkesave për sqarime ligjore kanë marrë përgjigje, në përmbushje të misionit të Inspektoratit Shtetëror të Punës “*t’u japë të dhëna dhe këshilla teknike punëdhënësit dhe punëmarrësit për mjetet më efikase të shqyrtimit të dispozitave ligjore*», duke ndikuar në këtë mënyrë në qartësimin e situatave dhe indirekt në zbutjen e konflikteve potenciale.

Numrin më të madh të denoncimeve të trajtuara i përkasin Drejtorisë Rajonale Tiranë me 64 %, Rajoni Vlorë 8%, Rajoni Korçë 4%, Rajoni Shkodër 3%, Rajoni Gjirokastrë 1%, Rajoni Dibër 1% dhe ankesa/kërkesa për informim dhe sqarime ligjore të trajtuara nga Drejtoria Qendrore 19%. Ankesat e adresuara sipas llojit të ankimit janë të pasqyruara si më poshtë:

Sipas arsyes së ankesës	Nr. Ankesa	Zgjidhja në %
Cënim të marrëdhënieve të punës	129	69%
Mospagesë e pagave të prapambetura	177	84.7%
Mospagesë të kontributit të sigurimeve shoqërore	78	69.2%
Punësimi të paligjshëm	29	34.4%
Ndërprerje të marrëdhënieve të punës	110	70.9%
Mosnjohim aksidenti në punë	9	33.3%
Kushte të pasigurta pune	9	88.8%
Mos pagesë të raporteve mjekësore	17	70.5%
Trajtim jo të barabartë në vendin e punës dhe diskriminim	7	57.1%
Zbatimi i kontratave kolektive, Pushimeve kolektive	15	26.6%
Të tjera	59	57.7%
Mos lidhje kontrate e mosrespektim i oreve të punës	18	77.7%
Punësim i paligjshëm të të miturve	3	66.6%
Kërkesa për sqarime / interpretime ligjore	140	100%
Totale	800	75%

Numri më i madh i denoncimeve të adresuara dhe të trajtuara nga ISHPSHSH janë ankesat për shkelje të të drejtave dhe mospërbushje të detyrimeve të punëdhënësve kundrejt punëmarrësve. Këto ankesa përfshijnë mospagesën për punë të kryer në ditët e festave zyrtare, ditë të pushimit javor, punë të kryer në orë shtesë, moslidhje kontrate pune, dhe çështje të ngjashme. Institucioni ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të përbushur standardet e punës, veçanërisht në zbatimin e kuadrit ligjor rregullues. Një vëmendje e veçantë është kushtuar gjatë këtij viti zbatimit të dispozitave ligjore, siç është Kodi i Punës, që synojnë forcimin e mbrojtjes së personalitetit të punëmarrësve në punë, duke siguruar trajtim të barabartë për të gjithë. Kjo tregon angazhimin e institucionit për të garantuar respektimin e të drejtave të punonjësve dhe për të promovuar një mjedis të denjë dhe të sigurtë në vendin e punës.

Në lidhje me denoncimet të cilat kanë të bëjnë me elementët mbi dhunën, ngacmimin dhe diskriminimin në vendin e punës, rezultojnë në numra relativisht të ulët, ndërkohë që Konventa C190 "Mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës", e cila është ratifikuar, tregon se ky fenomen prek një numër jo të vogël denoncimesh që adresojnë shkelje të të drejtave të punës, por që nuk raportohen në raste më vete. Per këtë qëllim ISHPSHSH-ja ka zyrtarizuar në Shkurt 2023 marrëveshjen e bashkëpunimit me Zyrën e Komisionerit Anti-Diskriminim, me objekt shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimit në kuadër të marrjes së masave për mbrojtjen nga diskriminimi, dhuna dhe ngacmimi në botën e punës. Gjithashtu në këtë kuadër janë zhvilluar trajnime dhe vizita studimore të përbëshkëta në subjekte të ndryshme, ku punëmarrësit janë prezantuar me hapat dhe procedurën që duhet të ndjekin pranë ISHPSHSH dhe KMD për të adresuar situata të dhunës, diskriminimit apo ngacmimit në vendin e punës.

Një fokus të veçantë gjatë vitit 2023 ka pasur edhe trajtimi dhe ndjekja ankesave dhe kërkesave nga organizata sindikale të cilat lidhen kryesisht me zbatimin e kontratave kolektive, ndjekjen e procedurave për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive si dhe në ushtrimin e lirive sindikale.

Duke marrë shkas nga përsëritja e ankësve nga punëmarrës të subjekteve, që ushtrojnë veprimtarinë e shërbimit privat të sigurisë fizike (SHPSF), në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional, rastet janë bërë prezente për problematikat e konstatuara (brenda kompetencës sonë) edhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si autoritet përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të SHPSF-ve sipas Ligjit nr. 75/2014.

Kategoritë e Veçanta të Punëmarrësve

Një fokus dhe vëmendje e veçantë në praktikën inspektuese mbetet edhe kontrolli i zbatimit nga ana e subjekteve të dispozitave ligjore të punës për kategoritë e veçanta të punëmarrësve, kryesisht “Punëmarrës nën 18 vjeç”, “Personat me aftësi ndryshe” dhe “Gratë shtatëzëna” dhe “Nënat më fëmijë në gj”.

Sa i takon kategorinë “**Punëmarrës nën 18 vjeç**” gjatë këtij viti pjesë e planifikimit të inspektimeve, janë bërë subjekte të cilat potencialisht mbartin punësimin e kësaj kategorie. Në kontrollet e ushtruara janë konstatuar 215 punëmarrës nën 18 vjeç nga të cilët 80 % i përkasin sektorit Tregti dhe HBR, 18% Ndërmarrje Prodhuese dhe 4% aktiviteteve të tjera. Kërkesa dhe autorizimi për leje pune për të mitur kryhet nëpërmjet portalit e-albania. Një vëmendje e veçantë nga trupa inspektuese i është kushtuar, krahas vlerësimit të punëdhënësit ana e ISHPSHSH-së, në rastet që ligji parashikon dhënien e Autorizimit Paraprak, vlerëson nëse ky punësim do të

kryhet sipas dispozitave ligjore në fuqi. Pas këtij vlerësimi ISHPSHSH-ja lëshon dokumentin “Autorizim për punësim nën 18 vjeç” rast pas rasti nëse kushtet plotësohen për punë të lehtë dhe që nuk çenojnë sigurinë dhe shëndetin e fëmijës.

ISHPSHSH-ja është pjesë e memorandumit të bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për identifikimin e rasteve të punës së detyruar dhe trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë. Qëllimi i memorandumit është zbatimi i ligjshmërisë për ndalimin e punës së detyruar, mbrojtjen e të dhënave personale, respektimin e të drejtës së lirisë së lëvizjes, mbrojtjen shoqërore të punës, mosdiskriminimin, si dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve. Në zbatim të VKM nr.129, datë 13.03.2019 “Për procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge”, në rastet kur janë konstatuar punëmarrës nën 18 vjeç që punojnë në punë të ndaluara apo punë të lejuara por në shkelje të disa kriterëve ligjore, rastet janë referuar tek strukturat përgjegjëse pranë Drejtorise së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale.

Në vizitat inspektuese, një vëmendje e vazhdueshme është kushtuar mbrojtjes shëndetësore dhe garantimit të sigurisë në punë për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji me qëllim për të siguruar që të drejtat e tyre të punësimit lidhur me kohëzgjatjen e punës, ndalimin e punës sipas parashikimeve ligjore në periudhat para dhe pas lindjes, si dhe mbrojtjen për largimin nga puna për shkak të shtatzënisë të respektohen dhe të zbatohen në praktikë.

Gjatë vitit 2023 në kuadër të projektit "Programi i asistencës teknike në mbështetje të barazisë gjinore në aksesin për mundësitë ekonomike" të zbatuar nga Expertise France, financuar nga AFD, u hartua udhërrëfyshi për barazinë gjinore në vendin e punës, për inspektorët, punëdhënësit dhe punëmarrësit, me qëllim arritjen e barazisë gjinore në zhvillimin e mundësive ekonomike të barabarta si dhe promovimin e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, zbatimin e legjislacionit të punës etj.

Një përpjekje e veçantë është bërë për monitorimin dhe ndjekjen e kërkesave për kryerjen e orëve shtesë në punë. ISHPSHSH si autoritet përgjegjës për dhënien e “Autorizimit për punë mbi numrin maksimal të orëve shtesë” siguron që kryerja e orëve shtesë për raste të forcave madhore ose punë urgjente në dobi të popullsisë të lejohen dhe zbatohen në përputhje me ligjin, duke garantuar që kjo praktikë të mos çenojë sigurinë dhe shëndetin në ambientet e punës.

Rritja e punëmarrësve të huaj në Shqipëri është një trend i vërejtur në vitet e fundit, dhe është e rëndësishme që të respektohen dhe të mbrohen të drejtat e tyre në punë për një trajtim të barabartë dhe larg çdo diskriminimi. Denoncime që kanë të bëjnë me shkelje të të drejtave të punëmarrësve të huaj përbëjnë një numër të vogël denoncimesh, 0,45% të totalit të ankesave, të cilat janë trajtuar me seriozitet dhe kanë marrë zgjidhje. Kjo tregon një angazhim të institucioneve për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve të huaj dhe për të kundërpërgjigjur ndaj çdo rasti të mundshëm të diskriminimit në vendin e punës.

Sektori i Mbikqyrjes për Sigurinë Dhe Shëndetin në Punë



Sektori i Mbikqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë realizon mbikqyrjen e procesit të inspektimit në punë në nivel rajonal mbi efektivitetin dhe cilësinë e tij në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës për të gjitha subjektet që janë objekt i kontrollit nga ISHPSHSH. Siguron dhënien e asistencës teknike për inspektorët e punës dhe përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve për zbatimin e Ligjit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Përmirësimi i kushteve të punës dhe garantimi i sigurisë dhe shëndetit janë prioritet për të gjitha subjektet dhe sektori ka një rol të rëndësishëm në këtë proces.

Menaxhimi i Hetimit dhe Inspektimit të Aksidenteve në Punë

Të dhënat statistikore në vitet e fundit kanë paraqitur nivele të ngjashme për numrin e aksidenteve të regjistruara dhe hetuara nga institucioni, ndërkohë që viti 2023 ka shënuar një ulje të lehtë në numrin e punëmarrësve të aksidentuar në total dhe atyre me vdekje. Kjo ulje në numrat e aksidenteve është një tregues pozitiv për përmirësimin e kushteve të sigurisë në punë dhe për efektivitetin e masave të ndërmarrë për të parandaluar aksidentet në ambientet e punës. Sektori i Mbikqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë administron “Rregjistrin e aksidenteve në punë të ISHPSHSH-së”, një mjet i rëndësishëm për monitorimin dhe raportimin e aksidenteve në punë në të gjithë strukturat e institucionit, duke mundësuar informacion të vazhdueshëm dhe analizë të rregullt të shkaqeve dhe trendeve në aksidente. Kjo informacion është i rëndësishëm për të identifikuar zonat me risk më të lartë dhe për të ndërmarrë masa për të parandaluar aksidentet në të ardhmen. Gjatë vitit 2023 janë rregjistruar gjithsej 218 raste për aksident në punë, të cilat pas verifikimit / hetimit kanë rezultuar që:

- 84.8 % kanë rezultuar aksidente në punë
- 15,2% nuk janë vlerësuar të jenë aksident në punë sipas parashikimeve ligjore.

Përveç detyrimit për njoftim dhe deklaram të një ngjarje nga punëdhënësi apo përfaqësues i tij, njoftimet për aksident në punë raportohen nga burime të ndryshme si media, prokuroria, policia e shtetit, punëmarrësi apo të afërm të tij. Rezultojnë që 87,6% e aksidenteve të raportuara të jenë njoftuar nga punëdhënësit, ose 5% më shumë se një vit më parë, gjë që tregon rritjen e ndërgjegjësimit të punëdhënësve për deklaramin e ngjarjeve pranë ISHPSHSH-së. Rritja e numrit të njoftimeve për aksidente në punë në formën e ankesës nga vetë punëmarrësi ose një i afërm i tij me 2.8% më shumë se në vitin 2022, është një indikator pozitiv që flet për rritjen e besueshmërisë së punëmarrësve në drejtim të institucionit. Njoftimi i aksidenteve në punë është kritik për të siguruar që rastet e aksidenteve të raportohen dhe adresohen në mënyrë të duhur.

Theksojmë se “Rregjistri i aksidenteve në punë” që administrohet nga Sektori i Mbikqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, përmban informacion mbi të gjithë rastet e ndodhura dhe të njoftuara gjatë një viti. Sipas këtij rregjistri, *për vitin 2022 janë rregjistruar 194 punëmarrës të aksidentuar nga të cilët 32 me pasojë humbjen e jetës*, ndërkohë që për vitin 2023 janë klasifikuar dhe vërtetuar si aksident në punë për 168 punëmarrës, nga të cilët 30 me pasojë humbjen e jetës. Vlen të cilësohet që 40 punëmarrës të aksidentuar apo 23.8% janë aksidente rrugore që klasifikohen si aksident në punë për shkak të ligjit, ndërkohë që në lidhje me aksidentet fatale nga ky klasifikim/kategori rezultojnë 9 punëmarrës me pasojë fatale për jetën. Gjithashtu janë rregjistruar 9 incidente në punë, praktikë kjo që dy vitet e fundit ka rezultuar pozitive në trajtimin dhe marrjen e masave në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë në subjektet në të cilat kanë ndodhur.

Automatizimi i procesit të planifikimit mbi bazë risku si dhe një bazë e përmirësuar të dhënash ka shërbyer dhe për të identifikuar problematika të shkeljeve të subjekteve, vlerësim më të mirë të shkaqeve të aksidenteve të hetuara, sektorët më problematikë në raport me këtë çështje duke ndërhyrë me masa konkrete për të parandaluar aksidentet në punë. Klasifikimi i sektorit të ndërtimit me risk të lartë kundrejt aksidenteve në punë, kjo dhe për shkak të zhvillimit të madh që ka kohët e fundit ky sektor në Shqipëri, ka shtuar vëmendjen tonë për të përmirësuar qasjen e inspektimit, ekzaktësisht duke e shtrirë kontrollin mbi bazë kantieri ndërtimi. Përmes Urdhërit nr.108 prot datë 02.06.2023 “Për kontrollin dhe monitorimin e aktiviteteve ndërtuese” të Kryeinspektorit të ISHPSHSH-së, është punuar dhe po punohet në monitorim të vazhdueshëm në këtë sektor. Në bazë të urdhërit të mësipërm, është mundur të krijohet një hartë e plotë me të dhëna për subjektet e ndërtimit që janë duke ushtruar veprimtarinë e tyre në terren. Në zbatim të urdhërit janë realizuar 1093 inspektime, verifikime, ku janë kontrolluar 9,317 vende pune gjithsej nga të cilat 36 % e tyre kanë shkuar me masa administrative. Gjithashtu në kuadër të përmirësimit të procesin të inspektimit për sektorin e ndërtimit janë zhvilluar dhe përdorur check-lista të dedikuara të cilat kanë rezultuar mjaft efektive për inspektorët e punës. Të gjitha keto veprime në analizën e institucionit rezultojnë të kenë dhënë një ndikim pozitiv sa i takon punëdhënësve të këtij sektori, të cilët po reflektojnë pozitivisht në përmirësim të kushteve të sigurisë në punë dhe masave për parandalimin e aksidenteve.

Rritja e përqindjes së subjekteve me "Dokument Vlerësim Risku", fuqizimi i rolit të Koordinatorit dhe Keshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë apo dhe Mjekut të ndërmarrjes tregojnë një angazhim të rritur për sigurinë dhe shëndetin në punë. Është e rëndësishme që ky angazhim të vazhdojë dhe të përmbushet në mënyrë efektive, duke siguruar zbatimin e legjislacionit dhe dokumenteve të vlerësimit të riskut në praktike për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve. Kjo përpjekje për të siguruar funksionimin e sistemeve të sigurisë dhe shëndetit në punë është kritike për parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale. Një nga objektivat kryesor të këtij sektori është informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut për sigurinë dhe shëndetin në punë nëpërmjet organizimit të aktiviteteve lokale, trajnimeve dhe fushatave të informimit që synojnë të sensibilizojnë të gjithë palët e interesuara për rregulloret dhe praktikën më të mirë në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Për më tepër, në kuadër të 28 Prillit “Ditës Ndërkombëtare të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”, e në veçanti “Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të punëtorëve që janë aksidentuar me vdekje ose jo”, është përgatitur një video informuese dhe këshilluese mbi rregullat për një punë të sigurt dhe të denjë. Gjithashtu si pjesë e Agjencisë Europiane të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë nëpërmjet pikës fokale, në kuadër të Fushatës Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë nën udhëheqjen dhe mbështetjen e kësaj agjencie, ky sektor promovon kulturën e sigurisë në punë dhe shpërndan materialet e përgatitura nga EU-OSHA si dhe organizon aktivitete të ndryshme në të gjithë Drejtoritë Rajonale të ISHPSHSH-së. Fushata "Vende pune të shëndetshme" për vitet 2023-2025 është një nismë e rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin për sigurinë dhe shëndetin në punë në kontekstin e teknologjive dixhitale. Kjo fushatë synon të trajtojë ndikimin e këtyre teknologjive në ambientet e punës dhe të ofrojë udhëzime për trajtimin e tyre. Me përkthimin e materialeve në gjuhën shqipe dhe dërgimin e tyre të ISHPSHSH, do të mundësohet që informacioni dhe udhëzimet të jenë në dispozicion të punonjësve dhe punëdhënësve për të trajtuar dhe përmirësuar sigurinë dhe shëndetin në ambientet e tyre të punës. Pas kësaj, pritet që të vijohet me zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për të promovuar dhe zbatuar praktikën më të mirë në këtë drejtim.

Sektori i Statistikës

Sales trends

	07-10	07-11	07-12	07-13
51	\$150	\$150	\$146	
09	\$100	\$100	\$0	
59	\$150	\$150	\$160	
5	\$3,000	\$3,000	\$7,300	
	\$2,000	\$3,000	\$58	
	\$12,000	\$10,000	\$13,400	
	\$0	\$0	\$0	
	\$0	\$0	\$3,750	
	\$200	\$200	\$0	
	1,200	\$2,000	\$0	
	\$0	\$0	\$0	
	1,800	\$18,600	\$24,816	
	867	\$12,947	\$16,044	
	581	\$15,635	\$19,268	
	95	\$18,364	\$22,491	
	10	\$21,072	\$25,715	
	4	\$23,781	\$28,949	



Sektori i Statistikës harton, përpunon dhe analizon të dhëna statistikore, që dalin nga procesi i inspektimit, sipas detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e ILO-s nr 81 “Për inspektimin e punës në Industri e Tregti”. Burimi kryesor i të dhënave të inspektimit bazohet në procesin e inspektimit të punës nga niveli Qëndror dhe Rajonal.

Analiza e treguesve statistikorë të inspektimit

Gjatë vitit 2023 janë inspektuar **9,938** subjekte ekonomike private e shtetërore, ku punonjës të punësuar në këto subjekte janë **216,594** të cilët janë vende pune të kontrolluara, me një mesatare 21.7 punëmarrës/subjekt dhe 125 mestare inspektimeve për inspektor.

Viti	Subjekte Private dhe Shtetërore			Subjekte Private		
	Inspektime Nr.	Nr. PM	Mesatare PM/Sub	Inspekime Nr.	Nr. PM	Mesatare PM/Sub
2023	9,938	216,594	21.7	9,820	201,678	20.5
2022	10,154	227,343	22.3	10,063	212,816	21.1

Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, treguesit dhe indikatorët kryesor të inspektimit shënojnë rritje, në raport me konstatimin e punësimit informal dhe numrit të inspektimeve me masa administrative të cilat flasin për rritje të vetë cilësisë së inspektimit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, në lidhje me numrin e inspektimeve rezultojnë 2.1% inspektime më pak, për shkak të vakancave në numër inspektorësh por që kjo nuk ka ndikuar tek treguesit cilësor të inspektimit.

Tabela: Treguesit kryesor të inspektimit të punës për vitin 2023, me bazë krahasimi vitin 2022 disagreguar në aspektin gjinor

Tregues Inspektimi	Viti 2022	Viti 2023
Subjekte të inspektuara Private + Shtetërore	10,154	9,938
Vende pune të inspektuara	227,343	216,594
Punëmarrëse femra Private + Shtetërore	118,539	106,368
Mesatare e punëmarrësve për subjekt	22	22
Subjekte private të inspektuara	10,063	9,820
Vende pune të inspektuara në Subjektet Private	212,816	201,678
Punëmarrëse femra në Subjekte Private	113,501	92,276
Mesatare e punëmarrës për subjekt në Subjekte Private	21	21
Punëmarrës pa kontrata individuale të evidentuar	2,946	2,502
Punëmarrëse femra pa kontrata individuale	1,202	1,047
Punëmarrës informal të evidentuar	1,799	1,965
Punëmarrëse informale femra të evidentuar	647	741
Punëmarrës informal të futur në skemën e SSH	1,785	1,949
Punëmarrëse informale femra të futur në skemën e SSH	643	741
Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar	171	215
Punëmarrëse femra nën 18 vjeç të evidentuara	55	75
Punëmarrës të huaj të evidentuar	722	1,350

Punëmarrës të huaj, pa leje pune	21	27
Punëmarrës me aftësi të kufizuar	111	103
Punëmarrëse femra me aftësi të kufizuar	35	25
Punëmarrës që kryejnë punën shtëpi (telepuna)	1,185	190
Punëmarrëse femra që kryejnë punën në shtëpi (telepuna)	689	119
Subjekte me masë “Pezullim” për marrëdhëniet e punës	940	936
Subjekte me masë “Pezullim” për sigurinë e shëndetit	98	179
Subjekte me masë “Paralajmërim”	1,226	1,243
Subjekte me masë Gjorbë	135	148
Vlera totale e sanksioneve (lekë)	28,340,000	43,735,000
Inspektime të programuara	7,737	8,254
Inspektime me tematikë	1,501	848
Inspektime për shkak ankese	520	544
Inspektim rastësor	188	74
Inspektime për shkak aksidenti në punë	208	218
Punëmarrës të aksidentuar në punë	184	168
Punëmarrëse femra të aksidentuara në punë	33	21
Punëmarrës të aksidentuar në punë me vdekje	32	30
Punëmarrëse femra të aksidentuara në punë me vdekje	1	1

Numri i kontrolleve, sipas arsyes së inspektimit.

Në analizën e inspektimeve/kontrolleve, sipas arsyes së inspektimit, rezultojnë se ISHPSHSH numrin më të madh të kontrolleve e ka mbi bazë planifikimi me 83% të totalit të inspektimeve, tregues pozitiv, në kushtet kur ky programim kryhet mbi bazë risku.

Arsye e inspektimit	Nr. Inspektimeve	% kundrejt totalit
Të programuara	8254	83%
Tematike, (riinspektim, kërkesë, këshillim, Ipard, etj.)	848	9%
Ankese	544	5%
Aksidenti në punë	218	2%
Rastësor	74	1%
Total	9938	100%

Tabela: Numri Inspektimeve të Programuara sipas Drejtoriave Rajoneve”, paraqet numrin e inspektimeve të programuara të kryera nga rajonet, së bashku me përqindjen kundrejt totalit.

Drejtoritë Rajonale	Inspektime Total	Inspektime të programuara	% kundrejt totalit
Rajoni I - Tiranë	6033	4,912	81%
Rajoni II - Vlorë	1085	906	84%
Rajoni III - Dibër	342	259	76%
Rajoni IV - Korçë	1220	1,113	91%
Rajoni V - Shkodër	648	551	85%
Rajoni VI - Gjirokastër	576	513	89%

Në drejtoritë rajonale që paraqiten me nivel më të ulët përqindje të inspektimeve të programuara, kanë ndikuar kryerja e inspektime jashtë program, si aksident në punë, denoncim nga të tretët, rastësorë për shkak të shkeljeve flagrante etj, mbi bazë të specifikës, që paraqet rajoni - **17 % e totalit të inspektime janë inspektime jashtë programimi.**

Tabela: Numri i inspektimeve “Jashtë Programimi”, paraqet numrin e inspektimeve jashtë programimi të kryera nga Drejtoritë Rajonale së bashku me përqindjen kundrejt totalit.

Drejtoritë Rajonale	Nr. Insp Gjithsej	Nr. Inspektimeve Jashtë Programi				% ndaj totalit
		Tematik e	Aksident Punë	Ankesë	Rastësore	
Rajoni Tiranë	6033	583	121	409	8	19%
Rajoni Vlorë	1085	89	24	58	8	16%
Rajoni Dibër	342	32	32	3	16	24%
Rajoni Korçë	1220	47	16	24	20	9%
Rajoni Shkodër	648	45	16	23	13	15%
Rajoni Gjirokastrë	576	38	8	10	7	11%
Drejtoria Qendrore	34	14	1	17	2	100%
Totali	9938	848	218	544	74	17%

Nga analiza e inspektimeve mbi bazë të llojit të aktivitetit ekonomik të subjekteve, inspektuar gjatë vitit 2023, rezulton se krahasimisht me një vit më parë, shënojnë rritje:

- 6.3 % rritje në Sektorin e Ndërtimit, për shkak të angazhimit të trupës, bazuar në Urdhërin e Kryeinspektorit të ISHPSHSH-së nr 108/02.06.2023 “Për kontrollin dhe monitorimin e aktiviteteve ndërtuese”.
- 5 % rritje në Sektorin e Tregtisë Hotele-Bare-Restorante, për shkak të vijimit të kontrolleve në kuadër të sezonit turistik
- 9 % rritje Aktivitete “Të tjera”. Në këtë zë, ka ndikuar kontrolli i subjeteve shtetërore, në zbatim të objektivitetit institucional për rritjen e kontrollit në këtë kategori subjektesh.

Kjo rritje është tregues i qartë i përputhjes së programimit/ orientimit të inspektimeve në raport me zbatimin e objektivave vjetore institucionale.

Tabela: Numri i Inspektimeve, sipas Llojit të Aktivitetit (ILO)

Lloji Aktivitetit	Nr. Inspektime 2022	Nr. Inspektime 2023
1. Bujqësi pyje peshkim	94	59
2. Miniera kariera	191	182
3. Ndërmarrje prodhuese	2,494	1,914
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	105	108
5. Tregti (H-B-R)	3,620	3,798
6. Ndërtim	1,680	1,786
7. Transport	256	235
8. Financë. Shërbime	77	62
9. Të tjera	1,637	1,794
TOTAL	10,154	9,938

Tabela: Numri i Inspektimeve sipas Llojit të Aktivitetit (ILO), në Nivel Rajoni.


Drejtoritë Rajonale	Lloji i Aktivitetit (ILO)									
	1. Bujqësi, Pyje Peshkim	2. Miniera kariera	3. Ndërmarrje Prodhuese	4. Elektricitet, Gaz, Ujë	5. Tregti (H-B-R)	6. Ndërtim	7. Transport	8. Financë, Shërbime	9. Të tjera	TOTAL
Rajoni Tiranë	8	3	997	20	2,232	1,254	140	17	1,362	6,033
Rajoni Vlorë	22	20	357	10	332	143	37	1	163	1,085
Rajoni Dibër	0	124	17	33	84	58	3	0	23	342
Rajoni Korçë	15	13	354	33	491	170	16	7	121	1,220
Rajoni Shkodër	11	13	93	9	313	94	27	34	54	648
Rajoni Gjirokastrë	3	9	93	3	344	56	10	3	55	576
Drejtoria Qendrore	0	0	3	0	2	11	2	0	16	34
TOTAL	59	182	1914	108	3798	1786	235	62	1794	9938

Më poshtë do gjeni analizë të detajuar për inspektimet e kryera jashtë programimi me arsye inspektimi ankesë, aksident në punë, kërkesë subjekti, treguesit e inspektimeve të cilave shërbëjnë si indikatorë të qartë të problematikave që ka shoqëruar tregun e punësimit gjatë vitit 2023, krahasimisht me më parë.

Treguesit e Inspektimeve që janë kryer mbi bazë “Ankese”

Gjatë vitit 2023, më çështje inspektimi me arsye « Denoncim nga të tretët » ose « Ankesë », rezultojnë gjithsej 544 inspektime. Krahasimisht me një vit më parë kemi 4.6% më shumë çështje inspektimi. Ky është tregues i rritjes së kulturës së ndërgjegjësimit, për të drejtat dhe detyrimet ligjore nga punëmarrësit dhe punëdhënësit, si dhe rritje të besimit ndaj institucionit duke njohur më mirë kompetencën e tij bazuar në ligj.

Grafik: Inspektimet për shkak “Ankese” sipas rajoneve për vitin 2022 dhe 2023



Numrin më i lartë subjekteve, që janë inspektuar në kuadër të ankesave të ardhura i takojnë Rajonit I – Drejtorisë Rajonale Tiranë me 75% të totalit të inspektim-ankesave. Gjatë 2023 ky rajon rezulton në këtë tregues me rritje me 16 inspektime më shumë se në vitin 2022, tregues që lidhet me faktin e përqëndrimit të lartë të bizneseve që zhvillojnë aktivitetin ekonomik në këtë rajon dhe për një ndërgjegjësim më të lartë të punonjësve të punësuar në këto subjekte për të adresuar shqetësimet e tyre për zgjidhje. Gjithashtu tregues më i lartë krahasimisht me një vit më parë është dhe numri i inspektimeve të kryera nga inspektorë të Drejtorisë Qëndrore, i cili tregon vëmëndjen e madhe që i është kushtuar trajtimit të ankesave për raste apo situata komplekse.

Tabela: Numri i inspektimeve për shkak “Ankese”, sipas Llojit të Aktivitetit (ILO), në nivel rajoni.

Drejtoritë Rajonale	Lloji i Aktivitetit (ILO)									
	1. Bujqësi, Pyje Peshkim	2. Miniera kariera	3. Ndërmarrje Prodhuese	4. Elektricitet, Gaz, Ujë	5. Tregti (H-B-R)	6. Ndërtim	7. Transport	8. Financë, Shërbime	9. Të tjera	TOTAL
Rajoni Tiranë	2	1	64	4	112	26	29	4	167	409
Rajoni Vlorë	1	6	26	0	12	2	2	0	9	58
Rajoni Dibër	0	1	0	0	0	1	0	0	1	3
Rajoni Korçë	0	0	9	0	1	1	1	0	12	24
Rajoni Shkodër	0	1	3	0	5	3	3	1	7	23
Rajoni Gjirokastrë	0	0	4	0	4	1	0	0	1	10
Drejtorija Qëndrore	0	0	3	0	2	1	2	0	9	17
TOTAL	3	9	109	4	136	35	37	5	206	544

Në bazë të llojit të aktivitetit ekonomik të subjekteve, inspektuar për shkak ankese gjatë vitit 2023, rezulton se sektorët, punëmarrësit e të cilëve adresojnë më shumë ankese janë;

- 38 % i takojnë Aktivitete “Të tjera”, ku bëjnë pjesë Ndërmarrjet Shtetërore, SHPSF (Shoqëritë e Ruajtjes së Sigurisë Fizike), Arsim, etj
- 25 % janë në Sektorin e Tregtisë (H-B-R), i cili vijon të ketë problematika për respektimin e kontratave të punës për punëmarrësit.
- 20 % janë në Ndërmarrje Prodhuese ku numri më i madh i përket sektorit fason, që gjatë këtij viti është shoqëruar me luhatje të tregut dhe rrjeshimisht ka dhënë ndikim dhe në raportet e punësimit me punëmarrësit/et.

Në **544 subjektet** të inspektuar në kuadër të ankesave, kanë rezultuar të punësuar gjithsej **35,916 punëmarrës** nga të cilët **53 % femra**. Përmes inspektimit të punës është ndikuar në përmirësimin e situatës së punësimit për të gjithë punëmarrësit sipas specifikës, që është trajtuar në kuadër të ankesës.

Në lidhje me konstatimet e marrëdhënieve të punës me informalitet të zi dhe gri, në inspektimet për shkak ankese kanë rezultuar;

- 85 punëmarrës informal apo të pasiguruar nga të cilët për 88% është bërë i mundur formalizimi i marrëdhënies së punësimit gjatë procesit inspektues. Diferenca është deleguar për kompetencë, rast pas rasti pranë Organeve të Tatim Taksave, për arsye të ankimimit në periudhë më të vonë së përfundimi i marrëdhënies së punësimit të ankuesve, në atë punëdhënës.
- 225 punëmarrës nuk kishin një kontratë pune punëdhënës – punëmarrës
- 5.501 punëmarrës ose 15 % e totalit të punëmarrësve, siguroheshin me pagë minimale, tregues i përmirësuar, duke patur parasysh që numri më i madh i punëmarrësve i takon Sektorit Fason.

Tabela: Informaliteti në inspektimet për shkak “Ankese”, sipas Llojit të Aktivitetit (ILO)

Lloji i Aktivitetit	Inspektime për ankese	Punëmarrës					
		Gjithsej	Femra	Pa kontrata	Informal	Formalizuar	Siguruar me pagë minimale
1. Bujqësi, Pyje, Peshkim	3	73	27	-	-	-	28
2. Miniera kariera	9	248	50	-	-	-	64
3. Ndërmarrje prodhuese	109	13,307	8,646	32	22	21	2,446
4. Elektricitet, Gaz, Ujë	4	1,276	566	-	-	-	-
5. Tregti (H-B-R)	136	3,698	2,030	64	36	34	305
6. Ndërtim	35	747	148	15	3	1	130
7. Transport, Telekomunikacion	37	3,746	1,825	32	7	5	550
8. Financë, Shërbime	5	705	187	-	-	-	163
9. Të tjera	206	12,116	5,392	82	17	14	1,815
TOTAL	544	35,916	18,871	225	85	75	5,501

Analiza e të dhënave të informalitetit në marrëdhëniet e punësimit të punëmarrësve në inspektimet për shkak “Ankese”, sipas llojit të aktivitetit ekonomik në raport me totalin e të punësuarve në këto subjekte rezulton në;

- 13,307 punëmarrës gjithsej, janë konstatuar 22 punëmarrës informal në “Ndërmarrje Prodhuese”
- 3,698 punëmarrës gjithsej, janë konstatuar 36 punëmarrës informal në aktivitete “Tregëti (H-B-R)”
- 747 punëmarrës gjithsej, janë konstatuar 3 punëmarrës informal në aktivitetin “Ndërtim”
- 3,746 punëmarrës gjithsej, janë konstatuar 7 punëmarrës informal në aktivitetin “Transport, Telekomunikacion”
- 12,116 punëmarrës gjithsej, janë konstatuar 17 punëmarrës informal në aktivitete “Të tjera”

Masat Administrative në inspektimet për shkak “Ankese”

51 % e subjekteve, që janë inspektuar mbi bazë ankese kanë marrë masa administrative, përkatësisht Masë urgjente “Pezullim”. “Paralajmërim”, “Gjobë”, të ndarë në përqindje:

- 13 % e subjekteve kanë marrë Masë Urgjente “Pezullim”, për shkelje flagrante, që lidhen me marrëdhëniet e punës dhe sigurinë e shëndetit në punë.
- 31 % e subjekteve kanë marrë dënim kryesor “Paralajmërim”.
- 8 % e subjekteve kanë marrë dënim kryesor “Gjobë”.

Krahasimisht me një vit më parë, kemi 25 % më shumë subjekte në të cilat janë aplikuar masa administrative ligjore të dënimit, përkundrejt numrit të inspektimeve për ankesë, tregues që flet për angazhim serioz të strukturës inspektuese për subjektet, që nuk zbatojnë ligjin.

Tabela: Masa Administrative në inspektimet për shkak “Ankese”, sipas Lloj Aktivitetit

Lloji i Aktivitetit (ILO)	Nr. Inspektime për shkak ankese	Masa administrative			
		Pezullim	Paralajmërim	Gjobë	Vlerë (.000) Lekë
1. Bujqësi pyje peshkim	3	0	2	-	-
2. Miniera kariera	9	0	8	1	280
3. Ndërmarrje prodhuese	109	14	38	9	3,910
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	4	0	-	-	-
5. Tregti (H-B-R)	136	27	35	8	908
6. Ndërtim	35	8	13	4	1,150
7. Transport, Telekomunikacion	37	5	12	7	1,940
8. Financë. Shërbime	5	0	1	1	360
9. Të tjera	206	14	57	12	2,201
TOTAL	544	68	166	42	10,749


Tabela: Masa Administrative në inspektimet për shkak “Ankese”, mbi bazë Rajoni.

Drejtoria Rajonale	Inspektime për shkak Ankese	Masa Administrative			
		Pezullime	Paralajmërim	Gjobë	Vlerë (000) Lekë
Rajoni I - Tiranë	409	54	102	27	5,788
Rajoni II - Vlorë	58	4	33	3	730
Rajoni III - Dibër	3	0	1	0	0
Rajoni IV - Korçë	24	4	13	2	400
Rajoni V - Shkodër	23	5	7	4	2,440
Rajoni VI - Gjirokastrë	10	1	3	1	680
Drejtoria Qëndrore	17	0	7	5	711
Totali	544	68	166	42	10,749

Treguesit e Inspektimeve që janë kryer mbi bazë “Aksidenti në punë”

Gjatë vitit 2023 rezultojnë të aksidentuar në punë **168** punëmarrës, nga të cilët **30** me pasojë humbjen e jetës. Numri i inspektimeve me arsye “Aksidenti në punë”, rezultojnë gjithsej **218**.

Të dhënat e inspektimit për aksident, që paraqiten në grafikun e mëposhtëm, për 3 vitet e fundit, tregojnë një trend në ulje të numrit të punëmarrësve të aksidentuar në punë, ndërkohë që numri i subjekteve që janë inspektuar për këtë shkak është në trend rritës. Këtu ka ndikuar rritja e cilësisë së hetimit të rasteve të aksidenteve në punë, përmes një analize më të thelluar të fakteve për të gjithë subjektet e përfshirë në ngjarje, pavarësisht faktit nëse kishin apo jo punëmarrës të lënduar në aksident.



Rajoni me numrin më të lartë të inspektimeve për “Aksident në punë” rezultojnë Rajoni I-Drejtoria Rajonale Tiranë, me shtrirje juridiksioni në qarqet Tiranë dhe Durrës me 121 subjekte të inspektuara për aksident në punë për këtë vit.

Tabela: Numri i inspektimeve për shkak “Aksidenti në Punë” dhe Numrit i Punëmarrësve të Aksidentuar dhe me Vdekje, mbi bazë Rajoni.

Drejtoritë Rajonale	Nr. Inspektimeve për Aksident në Punë	Punëmarrës	
		Të aksidentuar gjithsej	Të aksidentuar me vdekje
Rajoni I - Tiranë	121	82	14
Rajoni II - Vlorë	24	22	6
Rajoni III - Dibër	32	33	2
Rajoni IV - Korçë	16	19	4
Rajoni V - Shkodër	16	5	2
Rajoni VI - Gjirokastrë	8	7	2
Drejtoria Qëndrore	1	0	0
TOTAL	218	168	30

Tabela: Numri i inspektimeve për shkak “Aksidenti në Punë” dhe Numrit i Punëmarrësve të Aksidentuar dhe me Vdekje, mbi “Lloji të Aktivitetit” ekonomik.

Lloji i Aktivitetit (ILO)	Nr. Inspektimeve për Aksident në Punë	Punëmarrës	
		Të aksidentuar	Të aksidentuar me vdekje
1. Bujqësi pyje peshkim	-	0	0
2. Miniera kariera	25	26	1
3. Ndërmarrje prodhuese	43	38	3
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	10	7	1
5. Tregti (H-B-R)	21	11	2
6. Ndërtim	51	32	8
7.Transport,Telekomunikacion	9	8	3
8. Financë. Shërbime	3	2	1
9. Të tjera	56	44	11
TOTAL	218	168	30

Në këto inspektime si shkaqe të ndodhjes së aksidenteve në punë, lidhen kryesisht me moszbatim të rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë. Shkaqet konkrete sipas “Llojit të Aktivitetit” në pjesën më të madhe të rasteve të aksidenteve të hetuara gjatë 2023, në:

- “Ndërtim” shkak i aksidentit lidhet kryesisht me rënien nga lartësia
- “Ndërmarrje prodhuese” shkak i aksidentit lidhet me përdorimin e makinerive
- Tregti (H-B-R) dhe “Të tjera” kanë patur shkak atë të aksidentit rrugor, që konsiderohet si aksident në punë për shkak të ligjit.

Vendimarrja e inspektorëve të punës, në këto inspektime ka qënë e drejtpërdrejtë për përmirësim të situatës, përmes detyrave të lëna dhe masave administrative sic parashikon ligji.

Masat administrative në inspektimet për shkak “Aksidenti në punë”

Në **76%** të subjekteve që janë inspektuar në kuadër të aksidentit në punë janë marrë masa administrative përkatësisht; Masë urgjente “Pezullim”, “Paralajmërim”, “Gjobë”. Sipas përqindjes në raport me totalin i kemi;

- 8.2 % e subjekteve kanë marrë Masë Urgjente “Pezullim”, për shkelje flagrante që lidhen me marrëdhëniet e punës dhe sigurinë e shëndetit në punë.
- 42.2 % e subjekteve kanë marrë dënim kryesor “Paralajmërim”.
- 25.2 % e subjekteve kanë marrë dënim kryesor “Gjobë”.

Tabela: Masat administrative në inspektimet e kryera për “Aksident në punë”, mbi bazë Rajoni.

Drejtoria Rajonale/Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektime për Aksident në Punë	Masa Administrative			
		Pezullim	Paralaj mërim	Gjobë	Vlerë (000)
Rajoni I - Tiranë	121	10	36	29	6,650
Sek.Insp Tiranë	93	8	20	22	5,030
Sek.Insp Durrës	28	2	16	7	1,620
Rajoni II - Vlorë	24	4	13	6	2,700
Sek.Insp Vlorë	7	1	5	2	1,200
Sek.Insp Fier	8	1	3	2	1,000
Sek.Insp Berat	9	2	5	2	500
Rajoni III - Dibër	32	2	25	4	1,540
Sek.Insp Dibër	32	2	25	4	1,540
Sek.Insp Kukës	0	0	0	0	0
Rajoni IV - Korçë	16	0	13	5	1,140
Sek.Insp Korçë	1	0	1	0	0
Sek.Insp Elbasan	15	0	12	5	1,140
Rajoni V - Shkodër	16	1	3	9	4,600
Sek.Insp Shkodër	8	0	1	5	1,600
Sek.Insp Lezhë	8	1	2	4	3,000
Rajoni VI - Gjirokastrë	8	1	2	2	2,040
Sek.Insp Gjirokastrë	5	1	1	1	1,640
Sek.Insp Sarandë	3	0	1	1	400
Drejtoria Qëndrore	1	0	-	-	-
TOTALI	218	18	92	55	18,670

Treguesit e Inspektimeve që janë kryer mbi bazë “Kërkese” të subjektit

Pjesë jashtë programimi inspektimi janë dhe inspektimet e kryera mbi bazë “Kërkese” të subjekteve. Duke qënë se këto kërkesa adresohen drejtpërdrejt përmes sistemit “e-albania” nga subjektet, shërbime këto të zhvilluara në kuadër të “Reformës së Deregulimit”, e që rezultojnë për vitin 2023 të jenë realizuar **205** gjithsej, përkatësisht;

- 16.5 % për marrje “Autorizimi për punëmarrës nën 18 vjeç”
- 10.2 % për marrje “Autorizimi për të kryer punë në orë shtesë”
- 7.8 % për marrje “Leje pune para fillimit të punës në ndërmarrje”
- 65.3 % kërkesa IPARD -II

Këto inspektime, nga ISHPSHSH kryhen me njoftim paraprak për subjektet.

Tabela: Inspektimet mbi bazë kërkesë të subjekteve, mbi bazë rajoni.


Drejtoritë Rajonale	Nr. Kërkesave / Nr. Inspektimeve			
	Autorizim punëmarrës nën 18 vjeç	Autorizim për punë në orë shtesë	Leje pune para fillimit të punës në Ndërmarrje	
			Praktika të zakonshme	IPARD
Rajoni I - Tiranë	14	10	8	64
Rajoni II - Vlorë	4	6	13	23
Rajoni III - Dibër	0	0	0	9
Rajoni IV - Korçë	1	1	4	13
Rajoni V - Shkodër	3	3	0	9
Rajoni VI - Gjirokastrë	12	1	1	16
Drejtorja Qëndrore	0	0	1	0
TOTALI	34	21	16	134

Sipas të dhënave më sipër, inspektimet në kuadër të programit IPARD II, kanë peshën më të madhe në këtë lloj inspektimi dhe i përkasin aktiviteteve ekonomike “Bujqësi-Pyje-Peshkim” dhe Tregëti (H-B-R). ISHPSHSH është pjesë e trupave teknike, me fushë kompetencë verifikimi, kontrolli dhe monitorimi i zbatimit të standarteve të punës nga subjektet aplikante.

PUNËSIMI INFORMAL

Bazuar në ligjin 9634/2006 “Për inspektimin e punës” (i ndryshuar), përkufizimi “Punësim informal” përcakton një marrëdhënie punësimi, që nuk i nënshtrohet nga ana ligjore dhe në praktikë kërkesave të legjislacionit të punës. Në këtë analizë kemi zgjedhur të analizojmë indikatorët kryesorë të informalitetit duke përfshirë dhe informalitetin (gri). Më poshtë referojmë indikatorin e punëmarrësit informal të evidentuar dhe raportuar nga Rajonet në inspektimet e programuara dhe në inspektimet e kryera jashtë programit. Fokusi kryesor i institucionit ka qenë dhe mbetet minimizimi i informalitetit në marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës në çdo formë me të cilën shfaqet. Vlen të theksojmë në këtë krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë vihet re një rritje e numrit të punëmarrësve informal të konstatuar gjatë procesit të inspektimit me rreth **9.2 %**, tregues që lidhet me rritjen e performancës së inspektimit për të dërguar inspektimin në subjektet që mbartin më së shumti fenomenin.

Sipas viteve të dhënat jepen në Grafikon e mëposhtëm:



Një përmirësim në kontrollin dhe marrjen e masave të informalitetit për inspektimin e punës ka dhënë dhe programimi mbi bazë risku, ku elementët e informalitetit, kanë ndikuar në përzgjedhje të subjekteve që kanë risk më të lartë. Nga analiza e të dhënave statistikore në lidhje me elementët e informalitetit, konstatohet se;

- 1287 punëmarrës ose 65 % e punëmarrësve informal të konstatuar janë punëmarrës të subjekteve që janë inspektuar mbi bazë programimi apo planifikimi inspektimi.
- 678 punëmarrës ose 35 % e punëmarrësve informal të konstatuar janë punëmarrës të subjekteve që janë inspektuar jashtë programimi (inspektime Tematike, Ankesë, Aksident në Punë, rastësor)

Nga **1965** punëmarrës informal që janë evidentuar gjatë procesit të inspektimit, brenda procesit inspektues janë siguruar 1949 ose 99.1% prej tyre. Rastet për të cilat nuk është bërë e mundur formalizimi gjatë procesit, janë deleguar për kompetencë rast pas rasti pranë Organeve të Tatim Taksave. Të dhënat për punësimin informal në nivel rajoni dhe sektori paraqitet si më poshtë:

Tabela: Informaliteti mbi bazë Rajoni dhe Sektor Inspektimi.

Drejtoria Rajonale/ Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektimeve gjithsej	Punëmarrës		
		Gjithsej Punëmarrës	Informal	Formalizuar
Rajoni I - Tiranë	6,033	152,320	643	631
Sek.Insp Tiranë	5,034	122,060	506	498
Sek.Insp Durrës	999	30,260	137	133
Rajoni II - Vlorë	1,085	25,860	309	307
Sek.Insp Vlorë	179	3,718	70	69
Sek.Insp Fier	453	13,115	79	78
Sek.Insp Berat	453	9,027	160	160
Rajoni III - Dibër	342	8,487	168	168
Sek.Insp Dibër	317	8,370	167	167
Sek.Insp Kukës	25	117	1	1
Rajoni IV - Korçë	1,220	14,467	399	399
Sek.Insp Korçë	643	7,640	217	217
Sek.Insp Elbasan	577	6,827	182	182
Rajoni V - Shkodër	648	7,688	374	374
Sek.Insp Shkodër	310	3,345	177	177
Sek.Insp Lezhë	338	4,343	197	197
Rajoni VI Gjirokastrë	576	6,143	72	70
Sek.Insp Gjirokastrë	426	4,716	37	35
Sek.Insp Sarandë	150	1,427	35	35
Drejtoria Qëndrore	34	1,629	-	-
TOTALI	9,938	216,594	1,965	1,949

Më poshtë analizohet punëmarrësit informal të konstatuar në sektorin privat, pasi i gjithë informaliteti i konstatuar i përket këtij sektori.

Tabela: Informaliteti në subjektet private, mbi bazë Lloji Aktiviteti.

Lloji i aktivitetit	Nr. Inspektime Subjekte Private	Punëmarrës		
		Total Punemarrws	Informal	Në %
1. Bujqësi pyje peshkim	58	629	2	0.3%
2. Miniera kariera	182	7458	45	0.6%
3. Ndërmarrje prodhuese	1913	80928	328	0.4%
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	93	808	4	0.5%
5. Tregti (H-B-R)	3797	44101	965	2.2%
6. Ndërtim	1786	15582	489	3.1%
7.Transport, Telekomunikacion	230	8885	17	0.2%
8. Financë. Shërbime	62	1557	7	0.4%
9. Të tjera	1699	41730	108	0.3%
TOTAL	9820	201678	1965	1.0%

Një indikator matës për eficensën e punës së inspektorëve është mesatarja e numrit të informalëve të konstatuar për inspektor. Kjo mesatare për vitin 2023 është **25 Informal/Inspektor**. Krahasimisht me një vit më parë reflekton përmirësim të punës, pasi për vitin 2022 ky indikator rezulton në masën 21 Informal/Inspektor. Në raport me indikatorin i përlogaritur si numri i punëmarrësve të padeklaruar (informal) për subject të inspektuar, për vitin 2023 rezulton **5 informal/subjekt**. Nga inspektimet e kryera është verifikuar marrëdhënia e punësimit për 216,594 punëmarrës gjithsej nga të cilët 49% janë punëmarrëse femra.

Sipas kategorive të punëmarrësve rezultojnë;

- 0.09 % e punëmarrësve të evidentuar, janë punëmarrës nën 18 vjeç.
- 0.05 % e punëmarrësve të evidentuar, janë punëmarrës me aftësi të kufizuar (PAK).

Sipas elemntëve të punësimit që lidhen me kontratën e punës, kohëzgjatjen e punës, respektimin e pagës minimale, rezultojnë treguesit e mëposhtëm;

- 1.2 % e punëmarrësve janë evidentuar të punojnë pa kontrata individuale pune.
- 19.4 % e punëmarrësve janë punëmarrës që sigurohen në bazë të pagës minimale duke reflektuar një rritje rreth 1 % me një vit më pare

Tabela: Kategoritë e Punëmarrësve me shpërndarje mbi bazë Rajoni.

Rajoni /Sektori i Inspektimit	Punemarrës						
	Gjithsej	Femra	Pa kontrata individuale	Siguruar me pagë minimale	PAK	Nën 18 Vjeç	Të huaj
Rajoni I - Tiranë	152,320	80,159	806	22,236	19	126	597
Sek.Insp Tiranë	122,060	63,491	633	17,401	13	35	253
Sek.Insp Durrës	30,260	16,668	173	4,835	6	91	344
Rajoni II - Vlorë	25,860	12,401	403	7,122	11	17	512
Sek.Insp Vlorë	3,718	1,717	107	2,055	0	2	203
Sek.Insp Fier	13,115	6,769	121	3,201	11	8	103

Sek.Insp Berat	9,027	3,915	175	1,866	0	7	206
Rajoni III - Dibër	8,487	1,297	153	866	62	0	42
Sek.Insp Dibër	8,370	1,264	151	827	62	0	42
Sek.Insp Kukës	117	33	2	39	0	0	0
Rajoni IV - Korçë	14,467	6,129	491	6,245	6	13	68
Sek.Insp Korçë	7,640	3,040	304	3,949	0	1	4
Sek.Insp Elbasan	6,827	3,089	187	2,296	6	12	64
Rajoni V - Shkodër	7,688	2,832	405	2,337	3	41	64
Sek.Insp Shkodër	3,345	1,441	209	1,246	0	22	18
Sek.Insp Lezhë	4,343	1,391	196	1,091	3	19	46
Rajoni VI- Gjirokastrë	6,143	2,819	225	2,636	0	18	47
Sek.Insp Gjirokastrë	4,716	2,357	46	1,716	0	13	47
Sek.Insp Sarandë	1,427	462	179	920	0	5	0
Drejtoria Qëndrore	1,629	731	19	505	2	0	20
Totali	216,594	106,368	2,502	41,947	103	215	1,350

Punëmarrës pa Kontrata Individuale Pune

Një nga format e informalitetit në punësim është të punuarit pa një marrëveshje pune të shkruar. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar gjithsej 2,502 punëmarrës pa kontrata individuale pune në inspektimet e kryera ose rreth 1.2% e totalit të këtyre punëmarrësve të evidentuar gjithsej. Krahasuar me një vit më parë kemi **15 %** më pak punëmarrës pa kontrata pune.

Të dhënat për punëmarrës pa kontrata pune vetëm në subjekte private, sipas llojit të aktiviteteve ekonomike % më e madhe përkundrejt numrit të punëmarrësve në këto aktivitete evidentohet në llojin e aktivitetit: Tregti Hotel-Bar-Restorante me 3 %, Ndërtim me 2.7 %, Elektricitet Gaz Ujë 1.1% kundrejt numrit të punëmarrësve pa kontrata evidentuar në këto aktivitete gjatë procesit të inspektimit.

Tab. Punëmarrës pa kontrata individuale pune sipas llojit të aktivitetit.

Lloji i aktivitetit	Nr. Inspektime Subjekte Private	Punëmarrës		
		Në sektorin privat	Pa Kontrata Individuale	Në %
1. Bujqësi pyje peshkim	58	629	2	0.3%
2. Miniera kariera	182	7,458	39	0.5%
3. Ndërmarrje prodhuese	1,913	80,928	434	0.5%
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	93	808	9	1.1%
5. Tregti (H-B-R)	3,797	44,101	1,323	3.0%
6. Ndërtim	1,786	15,582	424	2.7%
7. Transport, Telekomunikacion	230	8,885	32	0.4%
8. Financë, Shërbime	62	1,557	6	0.4%
9. Të tjera	1,699	41,730	177	0.4%
TOTALI	9,820	201,678	2,446	1.2%

Punëmarrës që sigurohen mbi pagën minimale.

Punësimi me pagë minimale rezulton në masën 20 % të punëmarrësve të evidentuar në punë në aktivitetet private të inspektuara gjatë vitit 2023.

Tabela: **Punëmarrës që sigurohen me Pagë Minimale sipas Llojit të Aktivitetit.**

Lloji i Aktivitetit	Nr. Inspek Subjekte Private	Punëmarrës		
		Në sektorin privat	Siguruar mbi pagë minimale	Në %
1. Bujqësi pyje peshkim	58	629	231	37.0%
2. Miniera kariera	182	7,458	561	8.0%
3. Ndërmarrje prodhuese	1,913	80,928	14,013	17.0%
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	93	808	158	20.0%
5. Tregti (H-B-R)	3,797	44,101	12,666	29.0%
6. Ndërtim	1,786	15,582	4,423	28.0%
7. Transport, Telekomunikacion	230	8,885	1,519	17.0%
8. Financë. Shërbime	62	1,557	286	18.0%
9. Të tjera	1,699	41,730	7,022	17.0%
TOTALI	9,820	201,678	40,879	20.0%

Punëmarrës të Huaj

Rritja e punësimit të punëmarrësve të huaj me 86% krahasuar me një vit më parë solli një vëmëndje të veçantë në praktikën inspektuese në kontrollin e kushteve të tyre të punës për të siguruar që ata të kenë kushte të sigurta, të drejta dhe të barabarta në punë. Kjo gjithashtu thekson nevojën për Inspektoratin e Punës të vazhdojë të përqendrojë aktivitetin edhe në zbatimin e ligjit dhe në garantimin e respektimit të të drejtave të punëmarrësve të huaj

Tabela: **Punëmarrës “Të huaj”, të shpërndarë, sipas llojit të aktivitetit.**


Lloji i aktivitetit	Nr. Inspektime Subjekte Private	Punëmarrës	
		Të huaj	Pa leje pune
1. Bujqësi pyje peshkim	58	0	0
2. Miniera kariera	182	115	2
3. Ndërmarrje prodhuese	1,913	592	9
4. Elektricitet. Gaz.Ujë	93	4	0
5. Tregti (H-B-R)	3,797	195	0
6. Ndërtim	1,786	147	5
7. Transport, Telekomunikacion	230	20	0
8. Financë. Shërbime	62	0	0
9. Të tjera	1,699	277	11
TOTALI	9,820	1,350	27

Masat Administrative

Në vitin 2023, nga inspektimet e kryera, u vendosën 2506 masa administrative, që përfaqësojnë rreth 25% të subjekteve të inspektuara. Kjo tregon se gjatë inspektimit janë zbuluar shkelje të ndryshme të ligjit të punës dhe janë marrë masat e duhura për t'u korrigjuar ato. Masa administrative mund të jenë vendosur për shkelje të rregullave të sigurisë në punë, orëve të punës, pagave, etj. Në përqindje këto masa flasin për:

- 44 % janë “Pezullim” për shkelje flagrante të marrëdhënieve të punës dhe sigurisë në punë,
- 50 % janë “Paralajmërim”
- 6 % janë masa me “Gjobë”.

Në krahasim me vitet 2022 dhe 2021 treguesit kanë rritje dhe paraqiten si më poshtë,



Në lidhje me numrin e dënimeve administrative, për dënim kryesor "Palajmërim" dhe dënim kryesor "gjobë" në inspektimet që kanë rezultuar me shkelje të dispozitave ligjore, për të cilat inspektorët e punës kanë aplikuar dënimet administrative, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rezultojnë 4.2% më shumë masa. Kjo tregon se inspektimet janë më efektive në zbulimin e shkeljeve të ligjit të punës dhe në vendosjen e masave administrative për t'u korrigjuar ato, duke rritur përgjegjësinë e subjekteve në respektimin e ligjit.

Tabela: Masa Administrative, në shpërndarje, sipas Rajoneve.

Rajoni /Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektive	Masa Administrative				Në % kundrejt nr/ inspektimeve
		Pezullim	Paralajmërim	Gjobë	Totale	
Rajoni I - Tiranë	6,033	460	363	76	899	15%
Sek.Insp Tiranë	5,034	383	258	62	703	14%
Sek.Insp Durrës	999	77	105	14	196	20%
Rajoni II - Vlorë	1,085	158	465	12	635	59%
Sek.Insp Vlorë	179	32	111	3	146	82%
Sek.Insp Fier	453	42	56	4	102	23%
Sek.Insp Berat	453	84	298	5	387	85%
Rajoni III - Dibër	342	112	169	6	287	84%
Sek.Insp Dibër	317	111	160	6	277	87%
Sek.Insp Kukës	25	1	9	0	10	40%

Rajoni IV - Korcë	1,220	253	194	19	466	38%
Sek.Insp Korcë	643	128	74	8	210	33%
Sek.Insp Elbasan	577	125	120	11	256	44%
Rajoni V - Shkodër	648	76	29	26	131	20%
Sek.Insp Shkodër	310	33	6	9	48	15%
Sek.Insp Lezhë	338	43	23	17	83	25%
Rajoni VI- Gjirokastrë	576	53	10	4	67	12%
Sek.Insp Gjirokastrë	426	23	6	2	31	7%
Sek.Insp Sarandë	150	30	4	2	36	24%
Drejtoria Qëndrore	34	3	13	5	21	62%
TOTALI	9,938	1,115	1,243	148	2,506	25%

Rezulton që kundrejt numrit të inspektimeve,

- Rajoni III- Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së Dibër ka shkuar me masa administrative në 84 % të inspektimeve,
- Rajoni II- Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së Vlorë ka shkuar me masa administrative në 59 % të inspektimeve

Tabela: Masa Administrative, në shpërndarje, sipas Llojit të Aktivitetit (ILO)

Lloji i Aktivitetit	Masa Administrative	Në %
1. Bujqësi, Pyje, Peshkim	4	7%
2. Miniera kariera	138	76%
3. Ndërmarrje prodhuese	494	26%
4. Elektricitet, Gaz, Ujë	31	29%
5. Tregti (H-B-R)	969	26%
6. Ndërtim	522	29%
7. Transport	59	25%
8. Financë. Shërbime	8	13%
9. Të tjera	281	16%
TOTAL	2506	25%

Tabela: Masa Administrative (Pezullim, Paralajmërim, Gjorbë), në shpërndarje, sipas Llojit të inspektimit.

Lloji i Inspektimit	Nr. Inspektimeve	Totali i masave administrative	Në % kundrejt Inspektimeve
Inspektime të Programuara	8,254	1,759	21 %
Inspektime Tematike	848	199	23 %
Inspektime për Aksident në Punë	218	165	76 %
Inspektime për shkak Ankese	544	276	51 %
Inspektime Rastësore	74	107	145 %


Gjatë periudhës janar-dhjetor janë vendosur **148 gjoba** për shkelje të dispozitave ligjore:

- 48 gjoba në inspektime të programuara
- 55 Gjoba për shkak aksidenti në punë
- 42 Gjoba për shkak ankese (denoncime nga të tretët)
- 3 gjoba në inspektime rastësore.

Tabela: **Masa Administrative “Gjobë”, sipas Rajoneve/Sektorëve të Inspektimit**

Rajoni /Sektori i Inspektimit	Nr. Inspektive	Gjobë	Vlerë (000) Lekë
Rajoni I - Tiranë	6,033	76	16,214
Sek.Insp Tiranë	5,034	62	12,594
Sek.Insp Durrës	999	14	3,620
Rajoni II - Vlorë	1,085	12	4,730
Sek.Insp Vlorë	179	3	1,480
Sek.Insp Fier	453	4	1,800
Sek.Insp Berat	453	5	1,450
Rajoni III - Dibër	342	6	2,740
Sek.Insp Dibër	317	6	2,740
Sek.Insp Kukës	25	0	0
Rajoni IV - Korçë	1,220	19	2,620
Sek.Insp Korçë	643	8	580
Sek.Insp Elbasan	577	11	2,040
Rajoni V - Shkodër	648	26	13,600
Sek.Insp Shkodër	310	9	3,140
Sek.Insp Lezhë	338	17	10,460
Rajoni VI - Gjirokastrë	576	4	3,120
Sek.Insp Gjirokastrë	426	2	2,320
Sek.Insp Sarandë	150	2	800
Drejtoria Qëndrore	34	5	711
TOTALI	9,938	148	43,735

Drejtoria e Financës Dhe Shërbimeve Mbështetëse



DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Organizon dhe menaxhon punën për zbatimin e detyrave që lidhen me përdorimin me efektivitet të burimeve ekonomike, njerëzore, kualifikimin trajnues, sipas legjislacionit në fuqi dhe strukturës organizative. Harton projektbuxhetin e ISHPSHSH-së dhe administron buxhetin e miratuar për strukturën e ISHPSHSH-së, në përmbushje të objektivave të institucionit. Puna e kësaj drejtorie menaxhohet nga tre sektorë: 1) Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme; 2) Sektori i Çështjeve Ligjore; 3) Sektori i Financës.

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME

Sektori i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për rritjen e integritetit të institucionit dhe përmirësimin e kapaciteteve të tij nëpërmjet, rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit të punonjësve, zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, Kodit të Punës, komunikimit etik, me qëllim arritjen e objektivave të institucionit. Një departament i mirë i burimeve njerëzore është një aset i paçmuar në krijimin e një mjedisi funksional të punës që ndihet i hapur dhe i pranueshëm për të gjithë duke promovuar bashkëpunimin, profesionalizmin dhe integritetin.

Strukture Organizative

ISHPSHSH, si pjesë e administratës publike funksionon mbështetur në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Struktura e miratuar e ISHPSHSH-së, bazuar në Urdhrin nr. 156, datë 24.11.2020 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, është e organizuar në dy nivele: qendror dhe rajonal. Struktura ka në përbërje të saj 165 punonjës, në Drejtorine e Përgjithshme dhe 6 Drejtori Rajonale. Gjatë vitit 2023, dinamikat e strukturës kanë rezultuar me 7 nëpunës të emëruar dhe 14 të tjerë të larguar për arsye të ndryshme si dorëheqje, pension pleqërie apo lëvizje paralele. Për 2 nëpunës, në pozicionet inspektorë pune, me statusin e nëpunësit civil është marrë masë disiplinore nga Komisionet Disiplinore të ngritura gjatë vitit 2023, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë një vjeçare”. Në fund të vitit 2023 rezultojnë 22 pozicione vakante për tu plotësuar gjatë 2024.

Rritja e Kapaciteteve dhe Trajnimet

Gjatë vitit 2023 Sektori ka pasur objektiva të qarta për rritjen e kapaciteteve dhe performancës së personelit dhe trupës inspektuese në përgjithësi. Trajnimet, takimet dhe tryezat tematike kanë rezultuar mjaft të dobishme në zhvillimin e personelit duke sjellë përparime të rëndësishme në efikasitetin dhe efektivitetin e trupës inspektuese. Trajnimet e shtrira gjatë gjithë vitit, brenda dhe jashtë institucionit, janë të rëndësishme për të siguruar që i gjithë stafi të jetë në dijeni të kuadrit ligjor, praktikave më të mira për inspektimin e punës, si dhe për të përdorur mjetet efektive kundër dhunës dhe diskriminimit. Rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimet për zhvillimet e reja teknologjike kanë qënë gjithashtu të domosdoshme për të siguruar që trupa inspektuese të zotërojnë përdorimin e këtyre sistemeve në funksion të performances dhe cilësisë në kryerjen e detyrave në fushën e inspektimit të punës. Disa nga trajnimet kryesore të zhvillura janë listuar më poshtë:

- ASPA ka realizuar trajnime dhe sesione formuese mbi kuadrin ligjor edhe më gjërë në të cilin janë përfshirë gjatë gjithë vitit nëpunësit e ISHPSHSH-së.

- Trajnim mbi standardet ndërkombëtare dhe praktika kombëtare të lidhura me diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin në botën e punës dhe rolin e ndërveprimin e institucioneve inspektuese/monitoruese që përfshijnë fenomenin e diskriminimit, dhunës, ngacmimit, çështje e sigurisë dhe e shëndetit në punë, konventa 190 “Eliminimi i Dhunës dhe Ngacmimeve në Botën e Punës”, etj.
- Trajnimi i detyrueshëm për pranim në shërbimin civil, hyrje në administratën publike, për të përfituar Statusin e Nëpunësit Civil, për 11 nëpunësit në periudhë prove.
- Trajnimi gjithë trupa inspektuese për njohjen dhe përdorimin e platformave të reja teknologjike Matrica e Dënimeve (MPS) dhe Sistemi i Analizës së Riskut (RAS).
- Trajnim 2-ditor mbi etikën institucionale, udhëheqjen, kulturën organizative dhe analizë përmbyllëse e punës për vitin 2023 ku është përfshirë i gjithë personeli i ISHPSHSH.

Këto trajnime dhe aktivitete kanë ndihmuar në përmirësimin e aftësive dhe njohurive të punonjësve, duke i bërë ata më të përparuar dhe të aftë për të përballuar sfidat e inspektimit të punës në mënyrë efektive dhe profesionale.

Programi i Transparencës dhe Roli i Koordinatorit në ISHPSHSH

Programi i transparencës që funksionon sipas Ligjit nr. 119/2014 është një hap i rëndësishëm për sigurimin e të drejtës së informimit për qytetarët dhe interesantët në lidhje me informacionin e prodhuar dhe mbajtur nga ISHPSHSH-ja. Përmirësimi i qasjes dhe transparencës në informacionin publik është një praktikë e rëndësishme për të promovuar llogaridhënie dhe besueshmëri në institucionet publike. Mbajtja dhe përditësimi i koordinorit për të drejtën e informimit në faqen zyrtare www.inspektoriatipunes.gov.al dhe në adresën e emailit info@slj.gov.al të përcaktuar nga ligji janë hapa të rëndësishëm për të siguruar që kërkesat për informacion të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me ligjin. Kjo gjithashtu ndihmon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucionit.

SEKTORI I ÇËSHTJEVE LIGJORE

Sektori i Çështjeve Ligjore ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore në lidhje me legjislacionin në fuqi për ISHPSHSH-në. Kjo përfshin asistencën juridike për çështje ligjore, mbikqyrjen dhe administrimin e procesit të masave administrative nga inspektorët e punës deri te fazat e ankimit administrativ, gjyqësor dhe monitorimit të ekzekutimit të dënimeve me gjobë. Sektori i Çështjeve Ligjore gjithashtu ka përgjegjësinë për përfaqësimin ligjor të ISHPSHSH-së në çështjet ku ajo është palë. Përveç kësaj, shqyrton aktet e ardhura për mendim dhe propozon ose adreson nevojat për ndryshime ligjore që lidhen me fushën e veprimtarisë së ISHPSHSH-së. Kjo përfshin hartimin e propozimeve ligjore dhe përfaqësimin e tyre në procesin e hartimit të ligjeve në fushën e punës.

Dhënia e asistencës juridike për inspektorët dhe çështje specifike

Inspektorët e punës janë udhëzuar për zbatimin e drejtë të dispozitave të legjislacionit të punës dhe të ligjit procedural për rritjen e cilësisë së inspektimit ku fushat kryesore kanë qënë si rregullat mbi aplikimin e nenit 40 të Kodit të Punës, bazën ligjore të aplikueshme në rastet e konstatimit të punëmarrësve pa kontrata pune, afatin e paraqitjes së kontestimeve ndaj procesverbalit të inspektimit, rregullat e njoftimit të akteve të inspektimit, detajimi i shkeljes në procesverbalin e inspektimit etj.

Ndjekia e vendimeve me masa administrative

Për vitin 2023 janë 148 vendime përfundimtare me gjobë për shkelje të dispozitave ligjore. Kryesisht ato lidhen me dispozita të KP si neni 116 “Domosdoshmëria e pagesës”; Neni 118 “Mënyra e pagesës”; Neni 111 “Paga Minimale”; Neni 21 “Forma e kontrates se punes”; Neni 87 “Puna në ditën e diel ose ditën festave zyrtare”; Neni 119 “Përllogaritja e pagës”, neni 90 “Numri maksimal i orëve shtesë”; Neni 81 “Shtesa mbi pagë” etj., si dhe dispozita të ligjit nr.10237/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar si Neni 10 “Detyrime të punëdhënësit për hartimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë”; Neni 11 “Detyrime të punëdhënësit për garantimin e zbatimit të masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale”; Neni 25 “Detyrimi për njoftim dhe deklarim”; Neni 14 “Këshilli i sigurisë dhe shëndetit në punë” etj. Në 100 % të rasteve subjektet kanë marrë dijeni për vendimin përfundimtar të inspektimit, duke e shëndërruar atë në titull ekzekutiv. Ky është një rezultat i rëndësishëm që tregon për një proces transparent dhe një praktikë të mirë në aspektin e komunikimit me subjektet në njoftimin e vendimeve të inspektimit. Është gjithashtu vlerësuar që 55% e tyre janë njoftuar nëpërmjet dorëzimit personal, një metodë e cila siguron një komunikim të drejtpërdrejtë dhe më efikas me subjektet.

Administrimi i Komisioni i Ankimit të ISHPSHSH-së

Pranueshmëria dhe dakortësia me vendimet e inspektimit tregojnë për një tendencë pozitive në zbatimin e tyre. Kurba në ulje për vitin 2023 të vendimeve përfundimtare të ankimuara administrativisht, si dhe ulja e ankimeve ndaj vendimeve me gjobë, tregon për një rritje të besimit të subjekteve në procesin e vendimmarrjes dhe për një përmirësim të komunikimit dhe transparencës nga ana e institucionit. Ankimi i 30% të vendimeve me gjobë në vitin 2023 është një shifër mjaft e ulët krahasuar me vitet e mëparshme. Kjo tregon për një përmirësim të pranueshmërisë së vendimeve dhe për një marrëdhënie më të mirë të subjekteve me institucionin. Në vitin 2020, shifra ishte 64%, në vitin 2021 ishte 36%, ndërsa në vitin 2022 ishte 30%, duke treguar për një trend të qëndrueshëm drejt uljes së numrit të ankimeve. Nga regjistri i Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së rezulton se për vitin 2023, janë shqyrtuar 49 ankime ndaj vendimeve përfundimtare të inspektimit, nga të cilat 44 janë vendime me dënim administrativ gjobë, 4 janë vendime me dënim administrativ paralajmërim dhe 1 është vendim vetëm me detyra të lëna. Vendimarrja e trupës kolegjiale për akmimet e ushtruara për vitin 2023 është kryer brenda afateve ligjore, ku është vendosur për **43 vendime inspektimi lënia në fuqi**, **6 vendime inspektimi janë ndryshuar** (në 5 vendimarrje është vendosur për ndryshim të masës nga gjobë në paralajmërim dhe në 1 rast për ulje të vlerës së gjobës) dhe **shfuqizime kanë qënë zero**. Përmirësimi i puës inspektuese reflektohet edhe në faktin që asnjë vendim inspektimi nuk është shfuqizuar nga Komisioni i Ankimit të ISHPSHSH-së, ku krahasuar me një vit më parë, ka pasur 1 rast të tillë. Vetëm 15 vendime të Komisionit të Ankimit, ose 30% e tyre, janë ankimuar në Gjykatë, një shifër që është ulur krahasuar me vitin 2022, kur kjo shifër ishte 28%. Në 100% të çështjeve për të cilat gjykata është shprehur me vendim, është mbajtur në fuqi Vendimi i Inspektimit dhe i Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së.

Ndjekia e proceseve gjyqësore

Spektori i Çështjeve Ligjore ka bërë përfaqësimin ligjor në 39 procese gjyqësore, nga të cilat 33 janë ankime ndaj vendimeve përfundimtare të inspektimit dhe 6 çështjet me objekt ndërprerjen

e marrëdhënieve të punës nga stafi i ISHPSHSH-së. Në ato procese që kanë një vendim përfundimtar nga gjykata është vendosur:

- Në 17 çështje rrëzimin e kërkesë-padisë, ku SHPSHSH është gjyq-fituese.
- Në 5 çështje pranimin e kërkesë-padisë, ISHPSHSH ka humbur procesin duke rrëzuar 3 vendime përfundimtare të inspektimit të viteve të shkuara dhe 2 çështje me objekt ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të stafit të ISHPSHSH-së.

Rezultati që në 77% të rasteve gjykata ka vendosur ISHPSHSH si palë fituese tregon për një punë të mirë në përgatitjen dhe mbrojtjen e çështjeve gjyqësore nga ana e Sektorit të Çështjeve Ligjore dhe e ekipit të inspektorëve të punës. Rritja e cilësisë së procesit të inspektimit dhe e vendimarrjes së Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së, asistenca juridike e dhënë inspektorëve të punës, kanë qenë faktorë të rëndësishëm në arritjen e këtij rezultati. Ndjekja me profesionalizëm e proceseve gjyqësore tregon për një përkushtim të fortë të institucionit për të mbrojtur të drejtat e saj dhe për të siguruar zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë.

Ekzekutimi i gjobave

Për vënien në ekzekutim të dënimeve administrative me gjobë, Sektori i Çështjeve Ligjore ka ofruar asistencë dhe ka bashkëpunuar ngushtë me Komisioni i Ankimit të ISHPSHSH-së dhe Drejtoritë Rajonale. Ky bashkëpunim ka pasur një ndikim pozitiv në vijimin e procedurave të ekzekutimit të gjobave, duke siguruar që pas përfundimit të afatit të pezullimit të drejtës së ankimit administrativ, ekzekutimi i gjobave të vazhdojë sipas normimeve të legjislacionit në fuqi. Në vitin 2023, janë në proces të ndjekjes së ekzekutimit 100% të gjobave të vendosura, duke treguar për një përgatitje të mirë dhe një vullnet të qartë për zbatimin e vendimeve. Deri më tani janë likuiduar 41 % e gjobave të vitit 2023, me një vlerë prej 11,730,000 lekë, ku 35% e tyre janë likuiduar vullnetarisht. Ndërkohë mesatarja e likuidimit të gjobave ndër vite është 74% e masave dhe vlerës së tyre. Po ashtu, është vazhduar edhe me ekzekutimet e gjobave të viteve të shkuara, duke arkëtuar gjatë vitit 2023, 35 gjoba një vlerë prej 8,292,000 lekë në buxhetin e shtetit. Kjo tregon për një përgatitje të mirë dhe për një angazhim të vazhdueshëm për zbatimin e ligjit dhe për respektimin e vendimeve të inspektimit nga institucioni.

SEKTORI I FINANCËS

Buxheti i shtetit është instrumenti financiar kryesor për zbatimin e politikave dhe objektivave, ku pasqyrohen në mënyrë sistematike financiare të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit për një periudhë të caktuar. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore financohet tërësisht nga buxheti i shtetit dhe vlera në total e akorduar për vitin 2023 ka qënë 214 Milion Leke. Fondet buxhetore të çelura janë të detajuara në zërat e pagave (73%), sigurimeve shoqërore e shëndetësore (12%), mallra shërbime (12.6%) dhe investime (2.3%). Në kuadër të pavarësisë së menaxhimit të buxhetit, por edhe në zbatim të transparencës mbi përdorimin e fondeve buxhetore, bazuar në ligjin Nr.84/2022 “Për buxhetin e Vitit 2023”, udhëzimin Nr. 9, Datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.2, Datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, ju paraqesim realizimin e fondeve buxhetore për periudhën **Janar – Dhjetor 2023** sipas zërave buxhetorë:

Kodi	Emërtimi	Buxheti 2023	Plani 12-mujor	Fakti12-mujor	Realizimi %
600+601	Paga & Sigurime	181,928	171,520	169,255	99%
602	Mallra Shërbime	27,127	27,127	26,989	99%
231	Investime	5,000	4,500	4,274	95%
606	Fondi i veçantë	436	436	431	99%
	TOTALI	214,491	203,583	200,949	99%

Realizimi i buxhetit për vitin 2023 në drejtorinë qendrore është në masën **99%**, realizimi më i mirë i buxhetit ndër vite për ISHPSHSH-në. Përvoja e suksesshme me realizimin e buxhetit për vitin 2023 është një tregues i rëndësishëm për një mirëmenaxhim të fondeve buxhetore në drejtorinë qendrore dhe për institucionin është shumë inkurajues dhe tregon që planifikimi vjetor dhe administrimi është bërë me kujdes. Gjithashtu, realizimi i buxhetit në masën 99%, është një tregues i nevojës që ka institucioni për investime shtesë, të cilat janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës. Investimet shtesë në pajisje informatike, automjete, dhe rikonstrukcion i zyrtareve mund të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të trupës inspektuese. Duke përmirësuar logjistikën dhe duke investuar në nevojat e trupës inspektuese, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse mund të ndihmojë në sigurimin që trupa të ketë mjetet dhe burimet e nevojshme për të kryer punën e tyre në mënyrë efikase. Gjithashtu në të ardhurat e institucionit përfshihen edhe të ardhurat dytësore, të cilat përbëhen kryesisht nga gjobat e ekzekutuara së bashku me kamat vonesat e tyre. Këto të ardhura për periudhën Janar- Dhjetor 2023 kapin vlerën 20,556,013 lekë, të detajuara si më poshtë:

- të ardhura nga gjobat 18,962,000 lekë
- të ardhurat nga kamat vonesat 631,964 lekë
- të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve 42,380 lekë
- të tjera* 800,000 lekë

	2022	2023	Dif
Të ardhura nga gjobat	17,752,000 lekë	18,962,000 lekë	+7%
Realizimi i buxhetit	98%	99%	+1%

Gjatë vitit 2023, krahas investimeve të realizuara nga fondet brenda institucionit nga buxheti i shtetit, janë realizuar edhe investime të rëndësishme duke përfutur nga projekte me financime donatorësh të huaj, me një vlerë prej rreth 25,000,000 lekë. Këto investime kanë konsistuar në përmirësimin e infrastrukturës digjitale, duke përfshirë zhvillimin e dy sistemeve MPS 2.0 dhe RAS për përdorim nga trupa inspektuese, si dhe investimi për përmirësimin e rrjetit të brendshëm të internetit për ambientet e Drejtorisë Qendrore dhe Rajonale në Tiranë. Këto investime janë realizuar me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe financimin e Bashkimit Evropian (BE) në kuadër të Projektit ESAP 2. Këto investime kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë dhe shumë pozitiv në cilësinë e punës së institucionit, duke e bërë atë më efikas dhe të gatshëm për të përmbushur misionin e tij. Gjithashtu, me mbështetjen e projekteve nga donatorët e huaj, janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm trajnimesh për rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të institucionit. Këto trajnime kanë kontribuar në rritjen e aftësive dhe njohurive të personelit, duke e bërë ata më të kompetent për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efikase.

DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË STANDARTEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore ka si detyrë të garantojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ajo ka përgjegjësi për të kontrolluar dhe verifikuar zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në këtë fushë, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve të respektojnë standardet dhe procedurat e nevojshme për sigurimin e kujdesit dhe mbrojtjen e të drejtave të personave që marrin këto shërbime. Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore ka një rol kryesor inspektimin e ofruesve të shërbimeve, vlerësimin e standardeve për subjektet që duhet të liçensohen, inspektimin e ankesave dhe kërkesave të përfituesve dhe strukturave që mbrojnë të drejtat e njeriut. Përveç kësaj, ajo përditëson dhe menaxhon një bazë të dhënash për shërbimet, subjektet, njësitë vendore, NjMF-të si dhe inspektimet e kryera. Ky proces ndihmon në sigurimin e standardeve të larta të shërbimeve shoqërore dhe në mbrojtjen e të drejtave të personave që marrin këto shërbime.

Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore, pranë ISHPSHSH-së, është një strukturë e cila i është bashkëngjitur organikes së Inspektoriatit Shtetëror të Punës në vitin 2012. Kjo drejtori ka në përbërje një ekip prej 5 punonjësish, ku 1 është drejtor dhe 4 janë inspektorë. Ajo funksionon vetëm në nivel qendror dhe kryen inspektime në terren në fushën e shërbimeve shoqërore për të garantuar respektimin e standardeve dhe ligjeve në këtë sektor.

Aktivitetet dhe Arritjet kryesore të Vitit 2023

Bazuar në të dhënat e grumbullura në terren përgjatë ushtrimit të kontrolleve rezulton që në total operojnë rreth 502 shërbime, struktura dhe projekte që janë objekt ligjor kontrolli, informimi, verifikimi dhe vlerësimi të përmbushjes së treguesve të standardeve të përkujdesit si më poshtë:

- **117** shërbime të përkujdesit **rezidencial**, nga të cilat 42 janë publike;
- **203** qendra/njësi të të përkujdesit **komunitar**, (qendra ditore, gjysmë ditore, shërbime emergjente, shërbime në familje, shërbime terapeutike të specializuara, linja të këshillimit telefonik, etj), nga të cilat 59 klasifikohen shërbime publike;
- **119** projekte/shoqata në komunitet, për forcim kapacitetesh, asistencë e specializuar (psh. ligjore, këshillim psikologjik), kontribute, ndihma humanitare apo paketa ndihme emergjente;
- **61** Drejtori/Sektorë/Zyra të kujdesit social në nivel bashkie, të cilat ofrojnë shërbim parashoqëror, vlerësim, referim dhe menaxhim rasti, pjesëmarrje dhe vendimmarrje në Planin e Përkujdesit (*Punonjësi Social, PMF, KVMVDHF, Administratori Shoqëror, etj*).

Bazuar në përgjegjësinë ligjore dhe në synimin për garantimin e cilësisë së përkujdesit të ofruar nga subjekte publike dhe jopublikë, Drejtoria, përgjatë vitit 2023, ka realizuar programin e punës së saj, drejtuar nga 3 prioritetet:

1. Forcimi i kapaciteteve inspektuese të Drejtorisë së Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore, duke realizuar 21 tryeza teknike/ëorkshop-e në nivel kombëtar për forcimin dhe promovimin e rolit të inspektoriatit të kujdesit shoqëror. Fuqizimi i Inspektoratit për shërbimet e kujdesit shoqëror është një qëllim i rëndësishëm si i Ligjit

Nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, po ashtu edhe i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020-2023.

2. Garantimi i cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror nëpërmjet informimit, konsultimit dhe ofrimit të ekspertizës nëpërmjet organizimit të 2 takimeve në nivel qarku dhe bashkie
3. Kontrolli për respektimin të kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror duke realizuar **108 inspektime** të qendrave të përkujdesit shoqëror.

Nr.	Treguesi	Realizuar
1	Inspektime të planifikuara të Qendrave/Njësive të përkujdesit social	95
2	Inspektime të paplanifikuara të Qendrave/Njësive të përkujdesit social	13
2.1	Vlerësimi i standarteve të përkujdesit për efekt licensimi	3
2.2	Vlerësimi i standarteve të përkujdesit për procedurë verifikim ankese	6
2.3	Vlerësimi dhe informimi në Qendra të reja të evidentuara në terren.	4
3	Inspektime gjithësej	108

Planifikimi i inspektimeve për vitin 2023 u realizua bazuar në një proces diskutimi dhe vendimmarrje, duke përdorur ekspertizën dhe njohuritë e terrenit, lidhur ngushtë me numrin e subjekteve në rritje të vazhdueshme, burimet njerëzore të kufizuara, si dhe nivelin e ekspozimit ndaj diskriminimit, dhuna dhe abuzimi, në varësi nga tipologjia e përkujdesjes, siç është p.sh. bashkëjetesa në shërbim rezidencial, si dhe historikun e subjektit nga inspektimi i kaluar dhe masat apo detyrat e lëna

Propozimi për revokim të licencës për 6 subjekte jopublike, të licensuara për shërbime të kujdesit komunitar, është një masë administrative e rëndësishme që ka për qëllim të sigurojë respektimin e standardeve dhe ligjeve në fushën e arsimit parashkollor për fëmijët e grupmoshës 3-5 vjeç. Kjo masë tregon që inspektorati ka zbuluar shkelje të rënda dhe është duke ndërmarrë hapa për të garantuar standartet, të drejtat dhe sigurinë e fëmijëve.

Objektivat dhe Prioritetet për Vitin 2024

Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore do të vazhdojë të punojë për përmirësimin e standardeve të shërbimeve shoqërore duke u fokusuar në:

1. Përmirësimi i akteve nënligjore që kanë të bëjnë me statusin e Inspektoratit të Shërbimeve Shoqërore, riorganizimin dhe forcimin e strukturese se tij.
2. Përmirësimi i kuadrit ligjor që përfshin gjithë paketën e akteve nënligjore që lidhen me aspektet dhe instrumentet teknike të inspektimit, si edhe kompletimi i metodologjisë së inspektimit.
3. Fuqizimi i strukturave vendore të shërbimit social për tju shërbyer me cilësi të gjitha grupeve në nevojë me profesionistë, procedura dhe shërbime.
4. Inspektimet e rregullta dhe efektive duke synuar kryerjen e 120 inspektimeve në terren për të vlerësuar përmbushjen e standardeve në qendrat/shërbimet ekzistuese dhe të reja
5. Koordinimi dhe bashkëpunim me institucionet dhe organizatat relevante për të siguruar një mbikqyrje efektive të sektorit të shërbimeve shoqërore.

7. AKTIVITETE DHE PUBLIKIME

Komunikimi dhe informimi publik për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore janë thelbësore për të siguruar transparencën dhe për të ndërtuar marrëdhënie të drejtpërdrejta me publikun në lidhje me aktivitetin e institucionit. Duke përdorur mjete, kanale dhe platforma të ndryshme komunikimi, ISHPSHSH informon dhe ndërgjegjëson publikun në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të garantuar një ambient të sigurtë dhe të denjë për të gjithë. Krahas informimit dhe ndërgjegjësimin të punonjësve dhe punëmarrësve gjatë procesit inspektues, ISHPSHSH i kushton një rëndësi të veçantë edhe aktivitetëve të ndryshme, prezantimeve, tryezave të rrumbullakta apo marrëveshjeve ndërinstitutionale që ndikojnë në përmirësimin e punës së institucionit në përmbushje të misionit të tij. Aktivitetet kryesore të ISHPSHSH komunikohet në mënyrë efektive gjithashtu në kalanet digjitale të institucionit sic janë faqja web-it www.inspektoratipunes.gov.al, Facebook, Instagram apo e-mail zyrtar info@sli.gov.al

Fushatat ndërgjegjëse kryesore gjatë vitit 2023 kanë qënë:

- Fushata Ndërgjegjëse në kuadër të 28 Prillit “Ditës Ndërkombëtare të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, realizimi i një video informuese dhe vizita këshilluese në subjekte në të gjitha rajonet
- Fushata Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2020-2022 e udhëhequr nga Agjencia Europiane e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (EU-OSHA), nën sloganin “Vende Pune të shëndetshme, Lehtëso Ngarkesën”

10 RREGULLA PËR SIGURINË NË VENDIN E PUNËS

1. Çdo punëmtar duhet të jetë i përgatitur për siguri dhe shëndet në punë.
2. Ndaj rregullat dhe procedurat e kompanisë.
3. Përdorë çdo punë, vlerëso riskun, ndalo, mendo pastaj vepra.
4. Mos përdorë mjete ose makineri për të cilat nuk jeni të trajnuar.
5. Vihuni sic duhet, nga veshjet të kështu.
6. Mbrojini zonat e punës të rregulluara dhe të pastra.
7. Njëherë dhe ndiqni procedurat e emergjencës.
8. Mos i bëni shkurtyr.
9. Jini proaktiv.
10. Jini i përgjigjshëm.
11. Të gjithë aksidentet janë të parandalueshme.

28 PRILL DITA NDERKOMBETARE E SIGURISE DHE E SHENDETIT NE PUNE

SIGURIA MBRON NJERËZ

CILSIA MBRON PUNËN

Siguria dhe shëndeti në punë janë problem i të gjithëve. Më mirë për ju, më mirë për biznesin.


VENDE PUNE TË SIGURTA DHE TË SHËNDETSHME

QFARË KËRKON NË TË VËRTETË LEGJISLACIONI?

PARIME TË TEORISË SË VLERËSIMIT TË RISKUT

Fillozofia e SHPSHSH është parandalimi.
Parandalimi i rrezeve është filli dhe jo shpesh.

- Vizita inspektuese/informuese në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të Konventes C190 për informimin e punëmarrësve kundër dhunës dhe ngacmimit në botën e punës
- 9,333 subjekte ekonomike të reja e të sapo regjistruara në QKB, janë informuar nëpërmjet platformës "e-albania" mbi të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni i punës
- Rrreh 50 postime në rrjetet sociale dhe mbi 10 prezencë televizive për të ndërgjegjësuar publikun mbi punën e denjë, sigurinë dhe shëndetin në punë.



- Vizita inspektuese me bazë këshillimi në subjekte të ndryshme, duke shpërndarë fletë-palosjet informuese dhe këshilluese për krijimin e një ambienti pune të sigurt e të shëndetshëm.



Nënshkrime Marrëveshje dhe Takime Ndërinstitucionale

Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit i rishikuar ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Qëllimi i kësaj marrëveshje është rritja e ndërveprimit mes palëve si organe përgjegjëse që kanë tagrat dhe mandatin për kontrollin e çështjeve që lidhen me punën, dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, me qëllim parandalimin, reduktimin dhe adresimin e këtyre fenomeneve. Gjithashtu sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit dhe të bashkëpunimit në kuadër të marrjes së masave për mbrojtjen nga diskriminimi, dhuna dhe ngacmimi në botën e punës.



Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit në kuadër të zbatimit të programit IPARD III (2021 – 2027) ndërmjet ISHPSHSH dhe Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural. Përmbushja e standarteve kombëtare dhe të Bashkimit Europian EU në fushën e Sigurisë në Punë për investimet që do të kryhen në programin IPARD III. Objekt i këtij bashkëpunimi është përmbushja e standarteve kombëtare dhe të Bashkimit Europian në fushën e Sigurisë në Punë për investimet që do të kryhen në programin PARD III. Të gjitha investimet duhet të kryhen duke respektuar kriteret e Sigurisë në Punë të punonjësve.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Qendrës Kombëtare e Biznesit është një hap i rëndësishëm për të ndihmuar subjektet e reja në njohjen e rregulloreve dhe legjislacionit të punës në fuqi. Kjo marrëveshje synon të rrisë ndërgjegjësimin e bizneseve në lidhje me të drejtat dhe detyrimet ligjore që ata kanë për të përmirësuar standardet dhe sigurinë në punë, duke filluar nga momenti i regjistrimit fillestar si biznes pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



Raportim në Kuadër të Procesit të Integritimit në BE

ISHPSHSH pjesë e delegacioni shqiptar në Takimin Bilateral në Bruksel për Kapitullin 2 “Lëvizja e Lirë e Punëtorëve” me Komisionin Evropian. Liria e lëvizjes së punëtorëve është një nga liritë themelore të garantuara nga Bashkimi Evropian. Përveç përfitimeve të dukshme për individin, lëvizshmëria e fuqisë punëtore është e dobishme për ekonominë, si në vendin pritës ashtu edhe në atë vendas. Acquis, sipas këtij kapitulli parashikon që, qytetarët e BE-së të një shteti anëtar kanë të drejtë të punojnë në një shtet tjetër anëtar. Njëkohësisht, punëtorët migrantë të BE-së duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si punëtorët vendas në lidhje me kushtet e punës, avantazhet sociale dhe tatimore.



Zhvillimi takimit bilateral për Kapitullin 19 “Politikat Sociale dhe të Punësimit”, në Bruksel. Shqipëria vijon me adresimin e rekomandimeve të KE-së për punësimin dhe politikat sociale, veçanërisht duke forcuar cilësinë dhe efektivitetin e institucioneve të tregut të punës dhe ofrimin e shërbimeve të punësimit. Acquis në këtë fushë synon rritjen e punësimit, përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës, promovimin e dialogut me partnerët social, zhvillimin e burimeve njerëzore në mënyrë që të sigurojë punësim të qëndrueshëm, krijimin e mekanizmave të mbrojtjes sociale me standardet e duhura, luftimin e varfërisë dhe përjashtimit social dhe ofrimin e mundësive të barabarta. Delegacioni shqiptar u përfaqësua nga një numër i konsiderueshëm i strukturave teknike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përfshirë edhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.



Konferenca, Takime dhe Tryeza të Rumbullakëta

Konferenca Rajonale e ILO “Platformat e Punësimit dhe Çështjeve Sociale në Ballkanin Perëndimor - ESAP2”. Përdorimi i teknologjive të reja dhe inteligjencës artificiale në krijimin e mjeteve të vlerësimit të riskut në përpjekjet kundër informalitetit në tregun e punës, puna e padeklaruar dhe e nëndeklaruar, ishte përvoja pilot e ndarë nga ISHPSHSH, gjatë konferenca dy ditore u zhvillua në Tiranë me pjesëmarrje të lartë nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor.



Tryezën e rumbullakët diskutimi mbi zbatimin sa më mirë të Legjislacionit të Punës me kërkesë të Confindustria Albania dhe Shoqata e Industrialistëve Italianë në Shqipëri. Krijimin e kushteve sa më të sigurta dhe të shëndetshme për të gjithë punëmarrësit.



Zhvillim (AFD) dhe parterëve. ISHPSHSH në takimin e rradhës së Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e “Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit”, së bashku me përfaqësues nga ILO, MFE, MSHMS, institucioneve të tyre të varësisë dhe organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve.



Konferenca "Nxitësit e ndryshimit për zhvillim të barabartë ekonomik" e organizuar më 12 dhjetor 2023, mbajtur në COD (Qendra për Hapësirën dhe Dialogun) në Tiranë, shënoi një partneritet të rëndësishëm mes Qeverisë së Shqipërisë, Bankës Botërore, Agjencisë Franceze për



8. SFIDA TË HASURA

Disa nga sfidat më kryesore me të cilat është hasur Inspektoratin e Punës gjatë vitit 2023 përfshijnë:

- Orientimi i inspektimeve në subjekte me punëmarrës të huaj për të siguruar respektimin e të drejtave të tyre në punë, duke u përpjekur për të eliminuar diskriminimin në vendet e punës. Gjatë vitit 2023 rezultoi një rritje prej 86% të punëmarrësve të huaj të konstatuar.
- Kontrolli i zbatimit të ligjit për kategoritë e veçanta të punëmarrësve nën 18 vjeç, duke përfshirë subjekte që mund të kenë punësuar të mitur.
- Plotësimi i pozicioneve vakante për inspektorët e punës, duke pasur parasysh që 20 inspektues rajonalë janë në vakancë, që ndikojnë në numrin e inspektimeve.
- Vazhdimi i fushatave ndërgjegjëse për të nxitur kulturën e sigurisë dhe respektimit të ligjit në vendet e punës.
- Zgjerimi i harkut të subjekteve që përballen me inspektimin për herë të parë për të siguruar mbulimin sa më të gjerë të sektorëve të ndryshëm.
- Forcimi i kapaciteteve inspektuese, duke siguruar mjetet dhe mjete logjistike të nevojshme për inspektuesit, trajnime të specializuara për zhvillimet dhe teknikat e avancuara të inspektimit.

9. OBJEKTIVAT KRYESORE PËR VITIN 2024

Objektivat e përcaktuara për vitin 2024 shënojnë një hap të rëndësishëm në drejtim të fuqizimit dhe përmirësimit të procesit të inspektimit në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Një nga objektivat kryesore është fuqizimi i planifikimit me bazë risku, i cili do të ndihmojë në identifikimin dhe adresimin e më efektiv të rrezikut në vendet e punës. Ky proces i planifikimit do të shoqërohet nga monitorimi dhe zhvillimi i dashboard-eve të raportimit, që do të lejojë një përcaktim më të qartë të performancës së inspektoratit.

Në të njëjtën kohë, zhvillimi dhe përmirësimi i sistemeve digjitale, si Matrica e Dënimeve (MPS), Sistemi i Analizës së Riskut (RAS) dhe e-Inspektimi, do të sjellë një rritje të qartësisë dhe efikasitetit të inspektimit. Këto platforma do të lejojnë një ndërveprim më të lehtë dhe më të shpejtë me subjektet e inspektuara, duke ndihmuar në zbatimin e ligjit, rritjen e transparencës dhe cilësinë e inspektimit.

Një fokus i veçantë është vendosur në promovimin e një kulture parandaluese për vende pune të sigurta, të shëndetshme dhe produktive. Kjo do të arrihet përmes ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve për rreziqet e mundshme në vendin e punës dhe masave parandaluese për t'i adresuar ato.

Përbushja e detyrimeve institucionale për raportim në kuadër të procesit të integritetit në BE është gjithashtu një qëllim i rëndësishëm. Kjo përfshin pjesëmarrjen në zhvillimin e strategjive ndersektoriale dhe sektoriale, që do të ndihmojnë në përmirësimin e standardeve të punës në Shqipëri dhe përbushjen e kriterëve për anëtarësim në BE.

Në përgjithësi, këto objektiva tregojnë një qasje të qartë drejt modernizimit dhe përmirësimit të inspektoratit të punës në Shqipëri, duke u përqëndruar në zbatimin e standardeve të larta të punës dhe sigurisë në vendet e punës, si dhe në ritjen e profesionalizmit dhe etikës institucionale.